

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DEGA: GJUHË SHQIPE**



## **PUNIM DIPLOME**

**Ali Podrimja për poezinë e tij**

**MENTORJA:**

**Dr. Rovena Vata**

**KANDIDATI/JA:**

**MIRLINDA DUSHI**

Gjakovë, 2017

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DEGA: GJUHË SHQIPE**



## **PUNIM DIPLOME**

**Ali Podrimja për poezinë e tij**

Kryetar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

**MENTORJA:**  
Dr. Rovena Vata

**KANDIDATI/JA:**  
MIRLINDA DUSHI

Gjakovë, 2017

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>4</b>
1. Objekti dhe motivimi i temës.....	4
2. Metodologjia dhe metodat e punës .....	7
3. Baza teorike e punimit.....	8
4. Synimi i temës.....	8
<b>KREU I: Rëndësia e fjalës artistike dhe stilistika</b> .....	<b>11</b>
1. Unikaliteti i Podrimjes përmes veçorive poetike.....	11
1.1 Fjala e artit poetik të Ali Podrimjes.....	15
1.2 Dominatja, si shenjë dalluese .....	21
1.3 Stilistika .....	24
1.4 Larmia e stileve në hapësirën motivuese dhe krijuese.....	26
<b>KREU II: KRITIKA LETRARE</b> .....	<b>28</b>
2.1 Kritika recepsioniste .....	29
2.2 Kritika e introduktave.....	33
2.3 Kritika studimore .....	33
<b>KREU III: Vendi që zë vepra e Ali Podrimjes</b> .....	<b>36</b>
3.1 Në libra shkollorë .....	36
3.2 Në monografi.....	36
<b>KREU IV: Vlerësimi mbi personalitetin Ali Podrimja</b> .....	<b>37</b>
4.1 LUM LUMI.....	39
<b>PËRFUNDIME:</b> .....	<b>41</b>
<b>BIBLIOGRAFIA:</b> .....	<b>46</b>

# HYRJE

## 1. Objekti dhe motivimi i temës

Ky punim diplome që ka si objekt poetin kosovar Ali Podrimja është mbështetur në evidentimin, përshkrimin e vlerave letrare dhe gjuhësore të krijimtarisë poetike të tij, si dhe vendin e saj në poezinë shqipe.

Përgjatë analizës së lëndës poetike i është mëshuar së shumti aspektit të shprehjes dhe formave të artikulimit gjuhësor si rrugë e pasurimit të shqipes. Një vëmendje të veçantë u është kushtuar edhe disa problemeve të rëndësishme me karakter teorik si ligjërimin letrar, fjalës si njësi bazë e tij, marrëdhëniet semantike në raporte sintagmatike, strukturave të lëvizjes kuptimore dhe formave të sintetizimit.

Lëvizjet kuptimore në nivelin e sintagmës dhe kuptimet e figurshme, në poezinë e Podrimjes, përbëjnë një syth të rëndësishëm të punimit. Punimi hedh dritë mbi mjetet të realizimit të kuptimeve të figurshme, tendencën e tyre drejt përgjithësimit kuptimor leksikor si dhe forcën semantiko-formale të gjuhës shqipe, parë në raporte krahasimi në ligjërimin poetik të të dy autorëve.

Në punim është bërë një analizë e detajuar e mekanizmave të lëvizjes semantike. Përmes analizës, punimi sjell në vëmendje dukuritë të kohezionit gjuhësor në të gjitha rrafshet e gjuhës si: fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor dhe semantik.

Punimi përmban fjalorin poetik të veprave të marra në analizë. *Fjalë kyçe:* semantikë e figurshmërisë, art poetik, morfo – stilistika, sintakso – stilistika, semanto – stilistika.

Pothuaj që me lindjen, në fillim të viteve dyzet të shekullit të kaluar, Ali Podrimja zhvillon një betejë dramatike të pasosur: janë fati dhe fatkeqësitë kolektive dhe intime me të cilat do të përballet gjatë tërë jetës poeti i shquar shqiptar. Që herët do të mbetet jetim, pa nënën dhe pa babanë. Por jetim do të mbetet edhe karshi Kosovës së vet të lindjes, e cila ashtu siç e pa dhe e gjeti si fëmijë dhe të atillë e përcolli deri në fund të shekullit, do të jetë nën terror të pandërprerë, nën masakrat e pushtuesit të huaj. Dhe në këtë kontekst të fatit të vet dhe atij kosovar, poetin do ta godasë edhe fatkeqësia e quajtur Lumi-biri, të cilin ia rrëmbeu vdekja në moshën e re. Përballë këtij mozaiku të fatit kosovar dhe podrimjan, poeti Ali Podrimja do të zhvillojë një luftë stoike, me vullnet të ndezur, duke i përballuar të gjitha goditjet e fatit individual dhe kolektiv. E tërë poezia e tij, në fakt, bart në

vete shqetësimin, dramën, tragjizmin e këtij fati, duke u artikuluar si art majash në letërsinë bashkëkohore shqiptare, si art poetik që çan rrugë dhe pranohet si vlerë universale<sup>1</sup>.

Marrëdhënia simbiotike mes gjuhës dhe letërsisë ka bërë që letërsia të jetë objekt studimi për gjuhëtarët dhe gjuha për studiuesit e letërsisë. Shfaqja unike e gjuhës në komunikimin letrar, si një lloj i veçantë, është burim i zhvillimit të gjuhës në periudha të ndryshme. Në sistemet letrare zënë fill njësitë e reja leksiko – semantike të një gjuhe, ku në fillim shfaqen si përdorime të figurshme dhe më pas bëhen pjesë e natyrshme të vetëdijes gjuhësore të folësve të asaj gjuhe. Në historinë e zhvillimit të letërsisë së një kombi periudhat më të ndritura të saj, janë njëkohësisht edhe momente më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës.

Objekt i këtij punim diplome është hulumtimi dhe nxjerrja në pah e stileve krijuese mbizotëruese në poezinë shqipe bashkëkohore, konkretisht dhe me theks të poezisë së Ali Podrimja. Përmbushja e këtij synimi studimor nuk është e lehtë, për shkak se gjendemi përpara një procesi letrar të shumëfishtë dhe thujtë të pazotërueshëm, si nga pikëpamja sasiore e poezive të krijuara, po ashtu edhe nga pikëpamja e larmisë së prirjeve krijuese.

Njëherësh, shqyrtimi vështirësohet në përzgjedhjen konkrete të boshtit kronotopik brenda konceptit të bashkëkohësisë, sepse poezia shqipe në etapa dhe hapësira gjeografike të caktuara ka edhe specifikat përkatëse, që shpesh janë diktuar edhe nga rrethanat jashtëletrare. Mungesa e distancës kohore mbi objektin studimor, si dhe mangësia e studimeve të përthelluara monografike mbi prurjet stilistore në poezinë shqipe janë të tjera probleme dhe sfida që përballësh gjatë një ndërmarrjeje të tillë studimore. Duke qenë se poezia shqipe bashkëkohore është shumë e gjerë nga pikëpamja formale dhe lëndore, kjo do të rrezikonte që të bëhej një panoramë, thjesht duke prekur fenomene të përgjithshme dhe të mos thelloheshim në analiza konkrete. Për këtë arsye, epiqendër e këtij punimi do të jenë vetëm tre autorë, me të cilët kritika bashkëkohore është marrë më së shumti, për shkak të vlerave dhe risive të tyre krijuese.

Poezia e Ali Podrimjes (1942-2012), ashtu si edhe ajo e poetëve të brezit të tij – është rritur së bashku me poezinë e sotme shqipe të Kosovës, por lirisht mund të themi se ngritja e poezisë së këtij brezi shënon edhe ngritjen e poezisë shqipe të Kosovës dhe të asaj në përgjithësi, ndërsa sa u përket studimeve letrare shqiptare këtu, ato kanë shkuar krahas krijimit të letërsisë shqipe në këtë hapësirë. Sot, Ali Podrimja e gëzon epitelin e klasikut të poezisë shqipe. Me një krijimtari letrare të filluar para më shumë se gjysmëshekulli, poezia e këtij krijuesi që nga fillimi ka zgjuar interesimin e lexuesve dhe të kritikës nga të katër anët e trojeve shqiptare, por edhe përtej tyre, ndaj janë të rrallë kritikët shqiptarë, kryesisht ata që veprimtarinë e tyre e zhvilluan në trojet shqiptare në ish-

---

<sup>1</sup> Ali Podrimja, *Vepra 1*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 7-8.

Jugosllavi, të cilët së paku një herë nuk ia nënshtruan gjykimit të tyre kritik poezinë e tij. Kjo ndodhi pasi poezia e Podrimjes, me shumështrësinë dhe shumëkuptimësinë e saj, si dhe me vlerat e larta ideoestetike, kritikëve ua ka dhënë mundësinë të sprovonjë forcën argumentuese të kritikës së tyre, por edhe t'i korrigojnë dijet e tyre për fenomenin e letërsisë.

Larmia e madhe e stileve në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX, sidomos pas viteve '60, të mundëson përthyerjen në dritën e shumë aspekteve teorish e metodash të ndryshme, për shkak të larushisë që mbart kjo poezi në sferën strukturore, por edhe ideore.

Larmia e formave shkrimore, kryesisht llojshmëria e formave poetike në ditët e sotme lind domosdoshmërinë e analizave si formale dhe konceptuale mbi gjuhën e llojeve të ndryshme të poezisë. Letërsia si arti i fjalës gdhend formën e vargëzuar ose jo, me fjalën e lëvizjet kuptimore të saj. Të punosh eksperimentalisht mbi gjuhën dhe mbi kulturën që ajo vë në qarkullim, do të thotë pra të punosh në dy fronte: në frontin e shënjesit me fjalët (dhe kur shkatërron dhe riorganizon fjalët riorganizon mendimet) dhe duke luajtur mendimet, duke e çuar kështu fjalën të prekë horizonte të reja e të pamenduara<sup>2</sup>.

Lëvizja kuptimore me metaforë do të behët objekt i punimit tonë duke u ndalur në gjuhën e poezisë, kryesisht poezisë moderne. Ka pak studime mbi gjuhën e poezisë dhe ky punim shërben për të pasuruar sfondin e trajtesave mbi gjuhën e larmishme të poezisë. Poezia moderne zhvilloi dy nga konvencionet e saj kryesore: përdorimin e saktë, ndonjëherë dhe të tejmbushur me metafora, si dhe përdorimin e programuar të prozodive jo metrike. Metafora nuk është fakt gjuhësor formal, as “zbukurim i jashtëm, as lojë fjalësh”<sup>3</sup>.

Sipas Umberto Eko stilistika është specifikuar si një shkrirje në një të vetme e marrëdhënies së dyfishtë ndërmjet leximeve kulturore dhe interpretimeve individuale, duke mos ofruar as një mekanizëm objektiv për nxjerrjen e kuptimit<sup>4</sup> dhe as një papërcaktueshmëri në vetvete tërësisht subjektive, por vetëm një “bazament ndër subjektiv”. Në këtë raport, Jani Thomai shikon mundësinë e përligjjes nga gjuhësia funksionale shkëputjen e njësisive gjuhësore të abstraguara nga faktet konkrete të gjuhës dhe përse i duhej, pastaj, koncepti asociativ për të vendosur urën lidhëse,

---

<sup>2</sup> Umberto Eko, *Për letërsinë*, Shtëpia Dituria, Tiranë, 2008, f. 112.

<sup>3</sup> Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën*, f. 24.

<sup>4</sup> Në këndvështrimin tonë mbështetemi te kuptimi sipas funksionalizimit (A. Martinet). Në shkollën funksionaliste franceze, kuptimi leksikor shikohet si mundësi e lidhjes gjuhësore të konceptit me një asociacion. Koncepti lidhet me tërësinë fonetike (grafike) që e shënjon atë. Kuptimi paraqitet me një funksion tepër të qartë, atë të komunikimit. Ky funksion realizohet nga transportuesi foni (grafi). Edhe funksionalizmi e shikon kuptimin si një produkt logjik të realizueshëm nga marrëdhëniet shenjë – i shënuar në raportet dhe me karakteristikat e tyre.

ndemjet njësive gjuhësore dhe këtyre fakteve, për analogji ndëmjet fjalës si kategori abstrakte dhe njësive konkrete leksikore të gjuhës<sup>5</sup>.

Nga pikëpamja metodologjike, krahas qasjes analizuese të zbërthimeve të kuptimeve metaforike do të mbështetemi në idenë e stilit si mënyrë për të dhënë formë, që është në qendër të estetikës së Luixhi Parejsonit. Nëse vepra e artit është formë, mënyra për të formuar nuk i takon vetëm leksikut ose sintaksës, por edhe çdo strategjie semiotike që tirret qoftë në sipërfaqe qoftë në thellësi gjatë nervëzimit të një teksti<sup>6</sup>.

Duke u mbështetur në metodat e mësipërme do analizojmë ligjërimin poetik të poetit, ku gjejmë shprehje lëvizjet kuptimore me metaforë si: Ali Podrimja.

## 2. Metodologjia dhe metodat e punës

Nga ana tjetër, problemet e ligjërimin poetik janë parë në dritën e një analize të detajuar të poezisë së Podrimjes në raporte përqasëse. Lëvizjet kuptimore, në poezinë e Podrimjes, janë vështruar në strukturat minimale, ku ndodhin ndryshimet kuptimore, por nuk mendojnë rastet e analizës së strukturave më të mëdha në nivel të fjalisë apo edhe të thënies. Analiza në nivelin e fjalisë apo të thënies poetike është bërë për të parë lëvizjen kuptimore nga një njësi leksikore në tjetrën dhe plotësimin e strukturës kuptimore të ligjërimin letrar. Në përcaktimin e objektit të analizës kuptimore të poezive të Podrimjes dhe Mehmetit jemi përpjekur të jemi më të kufizuar, pasi krijimtaria poetike të dy poetëve është jashtëzakonisht e madhe dhe e larmishme. Në analizën tonë kemi përzgjedhur disa përmbledhje poetike të Podrimjes si: Sampo, Credo, Folja, Torzo në disa raste edhe përmbledhjen poetike Lum Lumi.

---

<sup>5</sup> Jani Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (semantikë leksikore)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, EDFA, Tiranë, 20009, f. 25.

<sup>6</sup> Umberto Eco, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 157.

### 3. Baza teorike e punimit

Për të realizuar këtë temë diplome si fillim jemi mbështetur në veprën e vetë autorit, në studime të bëra rreth personalitetit të poetit të Kosovës dhe studime që marrin në shqyrtim vlerat e poezisë së tij. Studime në revista periodike, studime teorike që na bëjnë të mundur të zhvillojmë horizontin e shqyrtimit të këtij punimi.

### 4. Synimi i temës

Vepra e Ali Podrimjes shënon një moment të rëndësishëm të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Për shkak të kushteve historike dhe shoqërore në të cilat mori jetë veprat e tij, Podrimja krijuan një sistem të veçantë komunikimi duke arritur në një përsosmëri formale. Në kushtet e censurimit, vepra e tij shfaqet si kërkim i formës gjuhësore më të sigurtë për të mbajtur të gjallë komunikimin me unin kolektiv. Po në këto kushte, ajo do të bëhet pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve në Kosovë, por jo vetëm. Madje shumë vëllime poetike të tij janë konsideruar me tendenca hermetizmi. Vepra e tij është dëshmi e plotë e zhvillimit të gjuhës shqipe në dy periudha të ndryshme të saj, para dhe pas kodifikimit të standardit. Në të njëjtën kohë, ai (me tendencë hermetizmi) është bartës i formave gjuhësore (leksikore, semantike, morfologjike dhe sintaksore) më “të çuditshme”. Krijimtaria e Podrimjes ka qenë objekt i studimeve të ndryshme në aspektin letrar në një qasje të analizës së vlerës letrare që mbartin si unikalitete të veçanta.

Dihet se kuptimi i poezisë është kontekstual, për shkak se “fjala bart me vete jo vetëm kuptimin që ka në fjalor si fjalë, por edhe areolën e sinonimeve dhe homonimeve. Fjalët jo vetëm kanë kuptimin, por edhe e grishin domethënien e fjalëve të tjera, të cilat janë të përafërta për nga tingëllimi, kuptimi, ose prejardhja- madje edhe të atyre që janë të kundërta, ose që përjashtohen”<sup>7</sup>.

Gjuha poetike ka një status të mëvetësishëm, që del jashtë funksionit të shenjës. Për të gjitha këto arsye, studimi i gjuhës bëhet shumë i rëndësishëm në procesin e analizës letrare, sepse në këtë mënyrë zërthehet struktura e vargut nga pikëpamja grafike, sintaksore dhe kuptimore.

Studiuesi Jean Piaget e përkufizon strukturën si një organizim të entiteteve që mishëron idetë themelore vijuese:

1) Tërësinë, e cila nënkupton se ajo është në koherencë të brendshme;

---

<sup>7</sup> Wellek & Woren, *Theory of literature*, Harcourt Brace & World, New York, 1956, f. 260.



2) Transformimin, i cili nënkupton se ajo nuk është një formë statike, por një aftësim i procedurave transformuese, ose që nuk është vetëm e strukturuar, por gjithashtu edhe strukturuese;

3) *Vetërregullimin*, i cili nënkupton se për të provuar ligjet e saj, struktura nuk ka nevojë të tërhiqet përtej vetvetes. Ky përkufizim i strukturës është përdorur gjerësisht nga lëvizja strukturaliste<sup>8</sup>.

“Struktura është koncept që përfshin edhe formën edhe përmbajtjen, gjithnjë nëse ato janë të organizuara për qëllime estetike. Në këtë mënyrë, vepra artistike shqyrtohet si një sistem shenjash, ose si strukturë shenjash që i shërben qëllimit të jashtëzakonshëm estetik”<sup>9</sup>.

Nga pikëpamja metodike praktike, është e pamundur që të përcaktosh një kufi ndarës mes mjeteve formale dhe atyre përmbajtjesore, për shkak se ato janë në bashkëveprim të pandalshëm dhe përplotësojnë njëra-tjetrën në funksion të tërësisë tekstore. Edhe pararendësit e strukturalizmit, formalistët rusë, e kanë kundërshtuar dikotominë formë-përmbajtje, me të cilën ajo ndahet në dy gjysma: në përmbajtjen lëndore dhe në formën e pastër të jashtme. Dallimi i formës si faktor estetikisht aktiv dhe i përmbajtjes si faktor indiferent estetik has në vështirësi të pakapërcyeshme. Këto vështirësi janë marrë parasysh në propozimin e teoricienëve Uellek dhe Uoren, të cilët duke mos hedhur poshtë marrëdhënien e pandashme bashkëvepruese mes formës dhe përmbajtjes, kanë bërë një zgjerim të këtyre koncepteve duke parashtruar idenë se të gjitha elementet estetikisht indiferente t’i pagëzojmë me termin “lëndë”, ndërsa mënyrën sesi ato e arrijnë veprimin estetik mund ta quajmë “strukturë”. Në dritën e këtij arsytimi, do të përvijohet edhe puna jonë me strukturën e poezisë së poetëve të marrë në shqyrtim, sepse të merresh me stilin krijues, do të thotë të identifikosh dhe të shpjegosh strukturën poetike, e cila përfshin, jo vetëm mjetet shprehëse, por edhe motivet, konceptet dhe temat.

Për vetë natyrën e temës, gjithashtu është e pashmangshme edhe qasja e elementeve sociologjike, për dy arsye: së pari, sepse në vendin tonë prirjet krijuese janë diktuar nga rrethanat e jashtme historike dhe së dyti, sepse lënda poetike është ushqyer nga ngjarjet e ndryshme të jetës e të historisë së shqiptarëve dhe depërtimi në kontekstet poetike realizohet përmes njohjes dhe referimit në rrethanat e jashtme. Kjo nuk do të thotë se çështjet do të shihet gjenetikisht, por do të bëhen përgjithësime teorike duke shqyrtuar gjendjen strukturale të poezisë shqipe sot. Pra, aspektet poetike e estetike, do të shihen në kuadër të kontekstit kulturor-historik.

Procesi i studimit të prirjeve krijuese të shpie edhe në fushën e studimit tipologjik të tekstit. Këndvështrimi tipologjik do të realizohet në bazë të analizës së elementeve dominuese në stilin e autorëve të përzgjedhur dhe përmes qartësimit të tipareve dhe specifikave, gjë që do të mundësojë

---

<sup>8</sup> Cituar sipas, Sol Saporta, “The Application of Linguistics to the Study of Poetic Language” in *Style in Language*, Indiana University, 1958, f. 88.

<sup>9</sup> Wellek & Woren, *Theory of literature*, Harcourt Brace & World, New York, 1956, f. 208.

krijimin e sfondit të përgjithshëm të stileve krijuese në poezi dhe të skajeve kryesore të kësaj larmie artshkruese.

# KREU I: Rëndësia e fjalës artistike dhe stilistika

## 1. Unikiteti i Podrimjes përmes veçorive poetike

Motivet tematike, idetë krijuese, kredoja unikale poetike, risitë strukturore stilistike, bota e pasur e poezisë me funksione të shumta, jo vetëm në artikulumin në trajtat më të plota dhe të mirëformuara të kredos poetike, por edhe për shfaqjen e mundësive dhe potencialeve semantike, leksikore, sintaksore dhe forcës shprehëse të të folmes nga ai vinte, e bëjnë Podrimjen një zë të veçantë në botën e letrave shqipe, madje e radhitin atë krahas kolosëve të kësaj bote.

*“Ali Podrimja bën pjesë në bërthamën e poetëve që hyjnë në letërsinë shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX dhe që me dhimbje dhe mundime prometeiane hap udhën për një zhvillim të fuqishëm të poezisë sonë”<sup>10</sup>.*

Ky poet botën e vet poetike e artikulon përmes një sistemi të mirëndërtuar figurativ (spikasin simboli dhe metafora), ku ndjehet shkalla e lartë e ndjeshmërisë. Poetika e Podrimjes përngjason me strukturat poetike të kryeveprave të letërsisë botërore, si me poetikën e *Komedisë Hyjnore* të Dante Aligerit.

Këtë e dëshmon struktura poetike e *Librit mbi të qenit* ashtu si vetë Podrimja që dëshmon mbi natyrën ekzistenciale dhe mitike të njeriut të tij. Te ky vëllim libër me një strukturë poetike trishtesore, ngjashëm me strukturën danteske të *Komedisë Hyjnore*. Tërë poetika dhe natyra e krijimtarisë së Podrimjes e bëjnë të denjë për të qëndruar në nivelet e krahasimit me poetët që hodhën themelet e kulturës kombëtare, me ata që i dhanë jetë gjuhës, kulturës dhe kombit. Ai mund të krahasohet me poetët e Rilindjes Kombëtare, por duke mbetur një nga dëshmuesit poetik nga më finët<sup>11</sup>.

Krahasimi i Podrimjes me kolosët e letërsisë kombëtare nuk mbetet vetëm në nivelin e poetikës, por më së shumti ai mbetet i krahasueshëm për nga temat dhe motivet tematike të poezisë së tij. Atdheu është një nga temat më të pranishme në poezinë e tij, atdheu i Podrimjes nuk ka shumë dallime nga ai i De Radës, Serembes, Skiroit, Asdrenit. Për Podrimjen atdheu nuk mund të kufizohet vetëm në marrëdhënien mes individit dhe vendit të lindjes, ai mbetet pjesë e shpirtit kolektiv të shqiptarit në të gjitha trojet. Podrimja, ashtu si Kuteli që sjell dramën e Kosovës në kohën e luftës, shtegton në trojet

<sup>10</sup> Fatos Arapi, *Në kërkim të lirisë, atdheut, njeriut*, parathënie e vëllimit poetik *Libri mbi të qenit* të Ali Podrimjes, Kosova Pen Center, Prishtinë, 2009, f. 5.

<sup>11</sup> Po aty, f. 14.

shqiptare në tërë hapësirën e tyre duke na sjellë bukuritë dhe dramën e humbjes së tyre. Në hartën poetike të atdheut të Podrimjes nuk mungojnë as skajet e trojeve shqiptare në gjenezën e përmendjes së tyre. Shkëputja e disa trojeve të atdheut për Podrimjen përbën dramën më të madhe të kombit tonë, ndaj bukuritë e tyre nuk mund të mos jenë pjesë e mozaikut poetik të poezisë së tij, duke u bërë njësh me tokën mëmë.

*“Ali Podrimja na sjell bukuritë dhe dhimbjet e jugut shqiptar, të Çamërisë. Në asnjë thërrmijë, nuk u ndaka dot, poeti nga gjuha, pra nga Atdheu; poeti nga gëzimet dhe vuajtja, pra nga Atdheu; poeti nga gjaku i tij, pra nga Atdheu, poeti nga jeta dhe vdekja, pra nga Atdheu”<sup>12</sup>.*

Në mënyrë metonimike, Podrimja krijon piramidën e marrëdhënies së shqiptarit në kohë me atdheun. Në poezinë *“Dinozaurët”* shqiptari hero del që në kohët mitike:

*Te Ura e Artës,  
Marko Boçarin Suliotin,  
Bajronin tek luante në rrufe,  
ç’na e zgjon ‘i ëndërr,  
Në katër shtiza,  
të katër kalorësve mavi,  
kokë e Ali Pashait,  
del dheu<sup>13</sup>.*

Njësitë nominative të toponimeve, për Podrimjen, shndërrohen në njësi poetike duke krijuar ura komunikimi mes subjekteve poetike të kolektivitetit etnik, madje ky komunikim është pjesë e traditës kulturore dhe si i tillë trashëgohet shoqërisht si pjesë e pandashme e ekzistencës ndër breza me shijen e hidhur të një historie të cunguar.

Poetikisht kjo marrëdhënie merr jetë në poezinë *“Ura e Artës”*, ku shqiptari shfaqet si një ravijëzim në rërën e kohës.

*Ti na qenke ajo ura që në heshtje të vdekshme,  
të kohërave të certa, kënduar të ka im atë,  
Bjeshkëve të namuna e krahasuar me Urë të Shenjtë,  
Urë moj Urë e Artës,  
Deri te guri yt i latuar nga mjeshtri epirotas,  
Udhë bëra vite e vite... Lumit tim sa vjet i duhen,  
Nëpër ty të kalojë me një lulëkuqe në dorë<sup>14</sup>.*

<sup>12</sup> Faruk Myrtaj, *Kur atdheu mungon, prej Arbërisë në Çamëri*, Albania, 14 shtator, 2003, f. 21.

<sup>13</sup> Ali Podrimja, *Vepra letrare 6, Rekuim për pyllin e prerë*, ASHAK, Alfa Print, Prishtinë, 2013, f. 138.

Njësitë ligjëruese të Podrimjes hartografojnë, jo vetëm shtrirjen e individit në kohë, por gjithë dramën e historisë së tij, të historisë si qenie në raport me veten, në raport me tokën e tij, po ashtu edhe në raport me të tjerët. Podrimja shqipton me forcë të madhe dramën e shqiptarit jashtë trungut mëmë, duke e shndërruar poezinë e tij, në jo pak raste, në poezi të dramës së vazhdueshme, në poezi të peshës së rëndë të fatit, të fatit të tokës së tyre Kosovës, por jo vetëm. Toka bëhet mit që krijon lidhjen më të fuqishme të lexuesit me poezinë e Podrimjes. Miti i tokës shfaqet që në fillimet e para poetike me poemën *Hija e tokës* (1961), natyrisht jo me këtë titull, por ky është titulli i variantit më të njohur (1979) dhe vazhdon në tërë hapësirën krijuese të poetit deri në vitin 2009 me përmbledhjen poetike *Libri mbi të qenit* ku trajta mitike ka marrë formën ekzistenciale të qenies në raport me formën e vet të parë, tokën. Podrimja këtë raport e sjellë përmes kodit të jetës së njeriut, të shqiptari, *këtë premisë ai e shndërron në parim për poezinë dhe, më tej në parim për ndërtimin e librit të jetës*<sup>15</sup>.

Poezia e tij mbart jo vetëm shenjat personale, por edhe shenja të kolektivitetit mitik si një rrugë pa kthim sa herë që kërkohet historia e një kolektiviteti.

Trajtëforma e mitikes së shqiptarit në poezinë e Podrimjes nuk mund t'i shpëtojë fjalës – këngës, me të cilën është ushqyer shpirtërisht në tërë ekzistencën e tij, përmes së cilës ka transmetuar dramën e tij, dritëhijet e “lumturisë” në kushte në ndryshme të historisë. Ndaj, fjala poetike e Podrimjes mund të konsiderohet si fjalë e dramave të mëdha në mesin e realizmit kolektiv dhe surrelizmit individual, në përjetimin dhe shfaqjen e ekzistencës. Poezitë e Ali Podrimjes janë në gjendje të krijojnë një shfaqje të plotë të dramave të mëdha, duke ligjëruar në situata poetike hiperrealiste, lakuar nga ndjesi gati paranormale, që ligjërojnë shqisën e dëshmisë më të plotë të një poeti që nuk di të jetë ndryshe, përveç atdheu i tij ose miti i atdheut – shqiptari model<sup>16</sup>.

*Marrëdhënia mes individit dhe kombit* mbetet e pashmangshme në poezinë e tij, duke e bërë këtë raport si dy anë të së njëjtës medalje dhe pjesë e shpirtit të subjektit lirik, një joshje e madhe e lexuesit të formës poetike të vetvetes. Nga një vëllim poetik në tjetrin, Podrimja kërkon në skutat e mistikës së individit, por nuk harron të krijojë hartën e mistikës së etnikumit të tij. Poezia e Podrimjes është poezi e të kuptuarit të individit nga njëra anë, dhe të etnisë e të kombit nga ana tjetër<sup>17</sup>.

---

<sup>14</sup> Ali Podrimja, *Vepra letrare 6, Rekuim për pyllin e prerë*, vep. e cit., f. 129.

<sup>15</sup> Vehbi Miftari, *Dëshmia, poetika ekzistenciale*, Tema, Tiranë, 7 mars, 2009, f.14.

<sup>16</sup> Dhurata Hamzai, *Poezia e Podrimjes, shqisa dëshmitare*, Tema, Tiranë, 31 korrik, 2008, f. 22.

<sup>17</sup> Baviola Shatro, *Poezi që sfidon*, Tema, Tiranë, 31 korrik, 2009, f.15.

Konteksti social, marrëdhënia e subjektit lirik me kohën, kanë bërë që, këtë dramë të historisë së cunuar mitike, ta formësojë përmes simbolikës shpirtërore të kulturës shqiptare që në fillimet e veta poetike me një mjeshtëri poetike të niveleve të larta, si një mundësi të mbijetesës dhe përsosjes formale të ligjërit.

*Hija e tokës* është një projektim i së ardhmes së ëndërruar dhe një shpalosje e së shkuarës të Kosovës ndër shekuj. E kaluara vjen që nga antikiteti, lashtësia e fisit të poetit e të kombit. Antikja e fisit të poetit (e Kosovës, e trojeve shqiptare) është një mburojë e madhe historike para një invazioni të egër serb mbi Kosovën. *Hija e tokës* është dëshmi e madhe e mjeshtërisë poetike të poetit, **të gjuhës ezopike** dhe të lirikës patriotike të artikuluar përmes gjuhës së figurshme, kryesisht përmes simbolit, metaforës, paralelizmave dhe parabolave krahasuese poetike. *Censurimi i fjalës së lirë në Kosovë bëri që të kemi një përsosje të gjuhës figurative të poetëve për të mbijetuar nga ndëshkimet e sistemit të dyfishtë diktatorial (serb dhe komunist)*. Kjo e bëri Podrimjen, ashtu si shumë autorë të tjerë, të arrijë kulmet e përsosjes gjuhësore e të figuracionit të thellë poetik. Poetika e Podrimjes është në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja dhe origjinale të shprehjes së emocionit, të imagjinatës dhe të filozofisë së jetës që vijnë dhe shfaqen përmes një simbolike të dendur në një cikël poezish: *Guri, Kulla, Cungu, Poema e heshtjes, Kali i Trojës, Dëftore dhe Pylli*.

Titujt e cikleve poetike të mësipërme janë kryekëput simbolikë. Simbolika e tyre na orienton drejt kulturës dhe historisë shqiptare. Simbolika e tyre është domethënie e pasurimit strukturor të këtyre leksemave, e një aktualizimi semantik të mbishtësëzimeve të tyre që nga kohët antike deri në kohët moderne.

- Guri është shprehje e qëndresës që në kohët e lashta, është shprehje e autoktonisë në vendin e tij.
- Kulla është simboli i qëndresës përballë invazionit të vazhdueshëm, është simbolika e shpirtit të shqiptarit në viset e Kosovës, është djepi i lirisë dhe intimiteti të tij personal.
- Cungu, simbol i cungimit të individit në një regjim diktatorial, shovinist, por edhe i mostjetërsimit edhe pse i cunuar.
- Heshtja, simboli i censurimit dhe të një mënyre të mbijetesës. Marrëdhënia përcaktuese mes fjalës heshtje dhe fjalës poemë, bën që leksema “heshtje” të ketë një mbishtësëzim kuptimor tjetër antonimik ku heshtja është një poemë, një rebelim i poetit. Heshtja është syri i fjetur me fyell në gojë, të cilit i cicërojnë zogjtë, ndaj ajo është më e vjetër se guri dhe më e fortë se vdekja.

Poetika e Podrimjes është strukturuar duke u mbështetur mbi metaforën, simbolin, por në fazën e tretë të krijimtarisë së tij kemi poetikë më të prerë, më të drejtpërdrejtë me një shkallëzim të ironisë deri në sarkazëm. Tradita kulturore, format e letërsisë gojore, konteksti social dhe historik të njëjtë për Podrimjen kanë bërë të mundur të kemi shumë pikëtakime në formë, temë dhe motive tematike mes këtij poeti të hapësirës gjeografike të njëjtë, të qytetit të Gjakovës. Pa frikë mund të pohojmë se ligjërimi poetik në gjuhën shqipe vazhdon në përsosjen formale të saj edhe më tej, në letërsinë shqipe në Kosovë, përmes poezisë së Ali Podrimjes.

Është e natyrshme, që ligjërimi poetik i gjithsecilit prej poetëve shfaq unikalitetin e tij në formën e ligjëritimit në orientimet e drejtimeve dhe rrymave, ndaj secili prej tyre qëndron si një zë i veçantë në botën e letrave shqipe.

## 1.1 Fjala e artit poetik të Ali Podrimjes

Fillesat poetike të Podrimjes, *pa dyshim njëri nga poetët sot më të afirmuar kosovarë, të njohur bukur shumë edhe jashtë regjionit gjuhësor shqiptar*<sup>18</sup> i gjejmë që në vitin 1957, me botimet e para në revistën *Jeta e re*. Paraqitja e parë poetike e Podrimjes është bërë me poemën *Hija e tokës*, e cila njeh tre variante botimi me tre tituj sipas gjuhëve në të cilat është botuar, përpara se të vijë në variantin përfundimtar: *Metohija në vjetin e madh* 1957 (varianti i parë i botimit, në revistën "*Jeta e re*", në vitin 1971), *Metohi – kullë e lartë* (variant i botuar në gjuhën serbo-kroate dhe maqedonase në vitin 1971) dhe së fundi *Hija e tokës* (varianti i fundit i poemës botuar në vitin 1979).

Në poezinë e Podrimjes jo vetëm që nuk mungon ndjenja e rebelimit, por ajo shfaqet në shumë raste e fortë dhe e artikuluar përmes disa tropeve gjuhësore të ndryshme, të sendërtuara te humori (i zi), satira, grotesku, ironia, fantastikja etj. Poezi me tipare të tilla i gjejmë në përmbledhjen poetike *Torzo, Pikë e zezë në blu, Sampo, Lum Lumi, Libri mbi të qenit, Te guri i Prevezës* etj.

Ironia merr një peshë të madhe në shprehjen e asociacioneve të krijuara në poezinë e Podrimjes, ajo është përdorur si mjet shumë i fuqishëm në shprehjen e temave, të motiveve tematike të ndryshme, në artikulimin në formën më të plotë të kredos poetike. Ironia në poezinë e tij nuk mund të jetojë e vetmuar, madje jetësohet përmes simbiozës simbolike dhe strukturës nominativë formë – përmbajtje:

---

<sup>18</sup> Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945 – 1980)*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 325 – 326.

*Mbi arkë të vjetër molla në pjatë,  
Thika nga antikiteti pranë,  
Shandani epirotas në fund të dhomës.....  
Se ka Shqipëri edhe tej Drinit,  
Nuk deshën ta pikëllojnë,  
Tiranasi... Luli i Lalës,  
Shoqin nuk e ka në kohë bubullimash<sup>19</sup>.*

Ironia e krijimit të tij merr rolin e një kritike te heshtur specifike për çështjet tona kombëtare, madje ajo fakton mbi trajtëformën prototipale të lashtësisë së këtij kombi<sup>20</sup>:

*Na tmerruan Shqipërinë,  
Edhe tej e tej e tej,  
Varre e nishana pikëlluese...  
Na bënë pikë e pesë Shqipërinë,  
Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen,  
Vaji na është këngë<sup>21</sup>.*

Ndjenja e rebelimit ironik shfaqet përmes teknikave të ndryshme si përmes antitezës dhe risemantizimit të simbolikës së hershme, rifunksionalizimit të rrëfimeve përrallore *Bukuria* etj. Në vargun *Na tmerruan Shqipëritë*, shfaqet estetika e filozofisë së shqetësimit imagjinar, pasi shqipëritë janë shqetësim imagjinativ i të tjerëve, vetëm si të tillë e aspak ndryshe.

Rebeli i Podrimjes metaforikisht (së shumti përmes epiteteve metaforike) nuk mbetet vetëm në rrafshin abstrakt, por ai është edhe kundër marrëdhënies mes njeriut dhe hyjnore. Metaforizmi i Podrimjes është në kahun e shprehjes së qenësisë së kohës, së qenësisë së njeriut.

Kjo e bën rebelimin e Podrimjes qëmtim i së vërtetës së njeriut, qëmtim i marrëdhënies mes vetes dhe unit, mes vetes dhe egos si pjesë e pandarë të qenies njerëzore.

*Evropës së përgjumur s'do t'i përulem,  
as perëndive të krisur,  
besën ma jep Lumi,  
se nuk do ta harrojmë vendlindjen<sup>22</sup>.*

<sup>19</sup> Ali Podrimja, *Pikë e zezë në blu*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 10.

<sup>20</sup> Shefqet Rizai, *Podrimja ironik, racional, i papërsëritshëm, Libri me poezi "Pikë e zezë në blu" na shëtit në fatin tragjik të kombit*, Tema, Tiranë, 23 dhjetor 2006, f. 20.

<sup>21</sup> Ali Podrimja, *Pikë e zezë në blu*, Onufri, Tiranë, 2005, f.10.

<sup>22</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 59.



Ndoshta nuk do të mjaftonin të gjitha shkrimet që janë shkruar mbi poetikën e Podrimjes për të treguar vlerën e saj estetike apo për të treguar larmishmërinë e saj, por për të treguar rëndësinë dhe formën, paraqitet shumë interesant pohimi i studiuesit Sadik Bejko që e karakterizon poezinë e këtij poeti si *Poezia e tij eliptike, e vargut lapidar e sentencave të shtrydhura gur me konstruktin e fjalëve të urta, me tragjiken e ngjeshur të një çasti*<sup>23</sup>.

Poetika e Podrimjes nuk duhet parë e fragmetarizuar nga një vëllim në një tjetër, por ajo është një tërësi unike e pandarë në tërë krijimtarinë e tij.

Poetika e Podrimjes mbart disa tipare që e bëjnë mozaikore dhe unike në tërë botën e letrave shqipe: në fillesat e saj nuk mungojnë diskursat narrative me nominacion fillestar të pranishëm, kurse në vijimësi ky nominacion shndërrohet në nominacion simbolik, ku mbizotërojnë konstruktet metaforike, metonimike dhe strukturimi i plotë i sistemit simbolik. Në kërkim të përsosjes së stilistikës dhe poetikës Podrimja krijoi sistemin e ligjërimit eliptik në të gjitha rrafshet dhe njësitë gjuhësore. Tradita dhe letërsia epike folklorike patën një ndikim të fortë në poetikën e tij, ndaj vihen re elementet e rrëfimit epik elegjiak; po ashtu kënga dhe fyelli nuk mbetën jashtë sferës së ndikimit në poetikën e Podrimjes, ashtu si te D. Mehmeti kënga mbetet ngjallje e gjakut të arbit, të Kosovës dhe vargut të tyre. Në poezinë e tij, Podrimja, na shpie në traditën kombëtare dhe kulturore të popullit të vet-te gjëegjëzat, këngët legjendare, poezitë klasike shqipe duke i shndërruar ato në ligjërimi bashkëkohore, të kuptueshme për njeriun e sotëm<sup>24</sup>.

Ndaj me plot gojën mund të themi se poetika e Podrimjes është e denjë për një kredo universale poetike si ajo e tij. Semantika poetike e Podrimjes nuk mund të kuptohet pa kuptuar semantikën e artit të proverbizmit, aforizmit dhe idiomës, kjo ndoshta nën ndikimin e poetikës biblike, poetikë që nuk i mungon poezisë së tij:

*Delja livadhit shëtiti Njeriun,*

*I lumtur se jeton thotë... Nikollë Marku,*

*i Atit i Dheut i at Dheut,*

*orë e tynzot,*

*Qoftë lavdruar*<sup>25</sup>.

Ndërsa poezia *Përmendorja e viçit* është aktualizimi jo vetëm i verbit biblik me funksionin e stigmatizimit të adhurimit heretik, me riaktualizimin e fortë mitik të formës së hershme biblike, por edhe një rebelim i poetit përmes ironisë.

---

<sup>23</sup> Sadik Bejko, *Ali Podrimja, poeti i estetikës*, Albania, Tiranë, 30 nëntor 2004, f. 20.

<sup>24</sup> Dorota Hrodyska, *E bukura fisnikëron të vërtetën*, Rilindja, Prishtinë, E mërkurë, 21 prill 1993, f. 9.

<sup>25</sup> Ali Podrimja, *Pikë e zezë në blu*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 9 – 14.

*Viçi ynë më në fund,  
Meriton një përmendore,  
Kasabanë na hijeshon,  
Do e puthin e shastisni,  
Në shesh diku të Nënës Terezë,  
I bukur e përralloj<sup>26</sup>.*

Forca semantike e shprehjes del e plotë përmes antitezës kontekstuale të sintagmave *viçi ynë* me *Nënë Terezën*, gjithnjë në funksion të sarkazmës pavarësisht formës së vargut biblik me të cilin shprehet ajo.

Vëllimi *Buzëqeshje në kafaz* është i ndërtuar mbi bazën e strukturës treshe të proverbit, aforizmit dhe idiomës. Kjo strukturë është e plotfuqishme në ciklin e tretë të kësaj përmbledhjeje, në poezitë e ciklit të tretë zotëron më shumë shprehja aforistike, proverbiale dhe idiomatike<sup>27</sup>.

Shprehja idiomatike, proverbiale dhe aforistike janë në funksion të plotë të mesazhit *poeti karshi subjektit lirik*, për të realizuar porosinë shekullore të shqiptarit, atë të mbijetesës në rrethana historike të tjetërsuara. Njeriu dhe toka e tij (atdheu) janë kredoja poetike edhe e Podrimjes. Në poezinë e tij, njeriu paraqitet në disa dimensione ekzistenciale, duke filluar në raport me kohën, me shoqërinë, me historinë, me realitetin që e rrethon dhe më së fundi me veten.

Fatos Arapi do të shprehet se bota poetike e Podrimjes është e ndërtuar mbi botën e njeriut midis jetës dhe vdekjes, ndaj ai (njeriu) i jep jetëvdekjes përmbajtjen e vet: kotësi, tragjedi, komedi. Rëndom jetëvdekja është tragjikomedi. Ndërsa Ali Aliu do të shprehet se Podrimja e ndërton fizionominë njerëzore parë në dy dimensione të vlerësimit dhe njohjes *Poezia e Podrimjes disponon dimensionin gnoseologjik (njohës) dhe akseologjik (vlerësues). Dimensionin i dytë ngërthen në vete edhe vizionin e besimit*<sup>28</sup> si elemente të ekzistencializmit.

Çështja ekzistenciale është determinuese e raportit të fundit të njeriut. Këtë raport e gjejmë në trajtën më të plotë në vëllimin *Lum Lumi*, por gjithnjë në simbiozë me raportet e krijuara me elementin social dhe të kohës (historisë). Dilema e ekzistencës është përballë vetvetes, përballë të ardhmes dhe së shkuarës së largët, në të cilën duhet rrëmuar në kërkim të

---

<sup>26</sup> Ali Podrimja, *Pikë e zezë në blu*, vep. e cit., f. 59.

<sup>27</sup> Abdulla Konushevci, *Poetizimi i situatave të ankthshme ekzistenciale*, Rilindja, Prishtinë, e diel, 19 dhjetor 1993, f. 7.

<sup>28</sup> Ali Aliu, *Kahdo që të nisem do të arrij te ti*, Fjala, nr. 3, Prishtinë, 1971, f. 8.

originës; duke vënë në funksion verbën e vet në kërkim të njohjes së formave dhe originës gjegjëse<sup>29</sup>

*Dhe shoh rëniën,  
por fundin askund*<sup>30</sup>.

Kërkimi i formës gjegjëse, originës, marrëdhënies me vetveten (emrin) mbeten në stadin e një pasigurie për të ardhmen (myshqë mbeten emrat e tyre) në bregun e poetit sepse sorrat janë rreth e për qark që grimcojnë myshkun pikturues të emrit. Kjo është mënyra se si artikullohet problemi universal i ekzistencializmit në natyrën e tij.

*Në bregun nuk dukesh,  
as valë e lumit tim,  
nuk të lagë më,  
Sorrat të dergjura,  
grimcojnë.  
Ëndrrën/  
dhe myshku emrin në gur*<sup>31</sup>.

Edhe pse i vetëdijshëm për marrëdhënien e njeriut me kohën, koha lë shenjë të hershmërisë me të cilën njeriu mund të identifikohet në konturimin e raporteve me historinë, me hapësirën edhe në kohë të largëta me njëra – tjetrën.

Ai mbetet në kërkim të kohës, ai fillon me historinë, lashtësinë, ku zë e ngjizet qenia dhe vetëdija dhe arrin deri në ditët tona ku e nesërmja është në pikëpyetje<sup>32</sup>.

Nga ana tjetër e tashmja përbën një nga nyjet më të rëndësishme në ekzistencën e njeriut, ndaj kuptimi i saj është vetë jeta, ekzistenca e qënies. Dëshmia artistike e poezisë së Podrimjes, kuintesenca e kredos së tij, le të shprehemi kështu, është pikërisht të përcaktojë të tashmen ku ai jeton, ta njohë, ta kuptojë këtë të tashme<sup>33</sup>.

E tashmja i jep mundësinë të qëndroj i palëvizshëm në raportin e vazhdimësisë biologjike ose në kohë. Sepse ai përjeton dhimbjen e madhe të ikjes së një pjese nga vetja: është koha kur ajo nuk fshihet, sepse ka zënë përmasa të patjetërsueshme në madhësinë e saj. Ndaj njeriu shfaqet në përmasat e veta në raport me hapësirën, edhe pse ai humbet, si humbet në kohë, gjurmë të tija mbeten në atë që e quajmë atdhe. Poeti mbetet në kërkim të qenies individuale

---

<sup>29</sup> Ramandan Musliu, *Mbindërtimi poetik*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 152 – 153.

<sup>30</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 27.

<sup>31</sup> Po aty, f. 24.

<sup>32</sup> Ramadan Musliu, *Poezi e ndjenjës së rëndë*, Ali Podrimja: “Lum Lumi”, Rilindja, Prishtinë, 1986, Thjerrëza, Nr.11, Prishtinë, 1 qershor 1986, f. 4.

<sup>33</sup> Fatos Arapi, *Podrimja, shprehës i shpirtit dhe mendimit shqiptar*, Albania, Tiranë, 29 gusht 2002, f. 20.

(Lumit), por nuk ikën nga qënia kolektive. Përsëri dolëm tek etnia kombëtare. Por unë e pranova dështimin qysh në krye, të gjithë nisen e përfundojnë tek etnia e madhe, kombëtare<sup>34</sup>.

Vazhdimësia historike e njeriut (subjektit lirik) me gjenezën etnike mbetet e projektuar jo vetëm në dëshirat (ëndrrat), por edhe në trashëgiminë e kohës (historisë).

*Ballkani nuk m'i ngjan pyllit,*

*ma kthen deti liburnën dashurinë,*

*qytete të humbura m'i kthen ëndrrat*<sup>35</sup>.

Ekzistenca e subjektit lirik, projeksonit të qenies së kërkuar, identifikohet me gurin, mbretin e vdekur dioklecian, liburnën dhe kullën. Pavarësisht se historia ka dëshmuar ekzistencën dhe mosekzistencën, subjekti lirik i Podrimjes është në dilemën e të ekzistuarit apo jo në sinkroni, kjo ka bërë që shumë studiues në sintagmën poetike të tij të shikojnë artikullimin e sintagmës hamletiane, ku funksioni sematik i saj është pasqyrimin e idesë se *njeriu është viktimë e rrethanave të prishura*<sup>36</sup>.

Ky identifikim është pozicionimi në sinkroni për të dëshmuar hershmërinë e ekzistencës jo vetëm përballë të tjerëve, por edhe përballë vetvetes si *një përballje mes lashtësisë dhe bashkëkohësisë* 113, një përballje mes individualitetit dhe etnisë.

Në përmbledhjen *Fundi i gëzuar* identifikimi i subjektit lirik vjen në tre dimensione në aspektin historik përmes personazheve historike, në aspektin mitologjik përmes personazheve mitologjike dhe përmes toponimisë e cila vjen me dy funksione në vetvete, me funksionin historik dhe me funksionin sinkronik. Toponimia, jo vetëm në këtë përmbledhje, shërben kontekstualisht si simbol derivues nga simbolika bazë, por që në vetvete në kontekstet e caktuara luajnë rolin e arketipave<sup>37</sup>.

Ky rol kontekstual i toponimisë nuk mund të kuptohet pa simbolikën bazë të vazhdimësisë, të lashtësisë dhe të qëndrësës: të gurit. Jo pa qëllim në vepër gjenden toponime si: Kruja, Rozafati, Albanopoli, Ura e Fshejt, Ura e Artës, të cilat valëviten fuqishëm në kujtesën kolektive të etnitetit të Podrimjes me dy funksione; me funksionin e të shprehurit të ashtuquajtur "fat" (ajo që koha bëri mbi to) dhe të rrëfimit mbi ekzistencës nën fatet e kohës mbi gurët e tyre. Marrëdhënia mes shqiptarit dhe gurit, me të cilin ai identifikohet, shfaqet në shumë nga përmbledhjet poetike të Podrimjes, por ajo merr një pamje të veçantë në vëllimin poetic

---

<sup>34</sup> Faruk Myrtaj, *Shndërrimi i Lumit në Perendi dhe Muzë, Një lexim tjetër i poezisë së Ali Podrimjes*, Albania, Tiranë, 18 qershor 2002, f. 18.

<sup>35</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 28.

<sup>36</sup> Ramadan Musliu, *Poezi e ndjenjës së rëndë, Ali Podrimja: "Lum Lumi"*, Rilindja, Prishtinë, 1986, Thjerrëza, Nr.11, Prishtinë, 1 qershor 1986, f.4.

<sup>37</sup> Agim Vinca, *Poezi e fatit dhe ekzistencës*, Fjala, Prishtinë, 1 - 15 Maj 1988, f. 15.

*Torzo*, në të cilin guri del si forma më e lashtë e shqiptarit që në periudhën e tij. Vazhdimësia simbolike e gurit në kohët moderne derivon simbolikën e kullës në të cilën merr jetë bota shpirtërore e shqiptarit. Metaforikisht Podrimja, shpreh qëndresën e gurit (për analogji të shqiptarit) në poezinë *Kohë e gurit* të vëllimit *Torzo*.

*Te bedenat e tua,  
mbretër e sulltanë,  
ushtritë lane,  
e kohërat sytë,  
njëra – tjetrës ia nxorën,  
te bedenat e tua,  
emrat tanë ngrihen në këmbë,  
e në kohën e karafilave,  
kohë e gurit fillon*<sup>38</sup>.

Asnjëherë dysia e unit dhe etnikumit nuk mund të jetë në mungesë në poezitë e tij, ndaj *Torzo* është një mundësi më tepër të kundërimit të *pamjeve të trishtueshme të popullit tonë nëpër periudha të ndryshme të ekzistencës në shekuj*<sup>39</sup>.

Qenia njerëzore në unikalitetin e saj me shumë vështirësi pranon ose jo humbjen e një pjese të saj, aq më tepër kur ajo pjesë është, duhet të jetë siguri e universalizmit biologjik të tij.

Podrimja, objektin lirik të tij e shikon të mbushur emocionalisht, nuk është objekt *tabula rasa*. Njeriu për të cilin këndon Podrimja është me botë të pasur emocionale, por tek i cili mbizotëron ndjenja e përjetimit tragjik të botës<sup>40</sup>.

## 1.2 Dominatja, si shenjë dalluese

Një nga tiparet më të rëndësishme që e identifikon stilin e autorit është koncepti i dominantes, apo i shpeshhtësisë së përdorimit. Këtë koncept e ka sqaruar në mënyrë të detajuar një prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të formalizmit rus, studiuesi Roman Jakobson, i cili dominanten e konsideron si elementin qendror të veprës artistike: ajo i orienton, i përcakton dhe i shndërron të gjithë përbërësit e tjerë të strukturës poetike. Është dominantja ajo që i jep veprës

<sup>38</sup> Ali Podrimja, *Litari i ankthit, poezi te zgjedhura*, Toena, Tiranë, 2002, f. 66.

<sup>39</sup> Halit Bogiqi, *Semantika dhe struktura e fuqishme e një poezie*, Fjala, Prishtinë, 1 prill 1979, f. 15.

<sup>40</sup> Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945 – 1980)*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 325 – 326.

veçanësinë dhe njëherësh, garanton tërësinë e strukturës, duke lidhur formën me përmbajtjen në një unitet të pandashëm.

Në lartësinë e vet artistike poezia e Ali Podrimjes shkëlqen misionare: poeti që nga fillimet ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, vizion që mund të konsiderohet edhe si një ndërmarrje donkishoteske e llojit të vet, e zëri i tij poetik do të jetë thellësisht tronditës, i mprehtë, i qëndrueshëm, bartës i dhembjeve së të gjithëve. Prandaj poezia e tij, e përcaktuar, e lindur në valët e këtij shqetësimi dhe misioni nuk do të jetë në asnjë rrethanë një latent dëshpërues, i pashpresë i vuajtjes dhe dhimbjes, por përkundrazi, vargu i tij do të jetë mobilizues në drejtim të mbrojtjes së frymës, do të jetë një mburojë e shpirtit kolektiv gjatë vuajtjeve epokale të popullit të vet dhe poezi pa të cilën vuajtja dhe dhembja do të ishin tragjike, të pashpresa dhe absurde. Ali Podrimja si poet kërkon dhe zbulon sferat, shtyllat mbajtëse më vitale brenda këtij oqeani vuajtjesh, duke shpalosur në artin e vet poetik burimet e shpesës dhe qëndresës<sup>41</sup>.

Kështu, në poezi konsiderohet si dominant ai element i cili e bën të dallueshëm varietetin e gjuhës së përdorur, ose e thënë ndryshe, që i jep veçanësinë një lloji të caktuar të gjuhës, dhe është pikërisht ky element i cili e dominon të gjithë strukturën; ai është konsituenti i saj i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm që dominon mbi elementet e tjera dhe ushtron ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Mirëpo, vetë vargu nuk është nocion i thjeshtë dhe as nuk përfaqëson një njësi të paanalizueshme në pjesë përbërëse. Vargu është sistem vlerash; dhe si çdo sistem tjetër vlerash, ai e posedon hierarkinë e vet të vlerave më të larta dhe më të ulëta, dhe një vlerë kyçe dominanten, pa të cilën (në kuadër të periudhës së dhënë letrare dhe të një drejtimi letrar të dhënë) nuk do të mund të pranohej dhe të vlerësohej si varg.

Tipari specifik i gjuhës në varg dihet se është gjedha prozodike e tij, trajta e vargut etj. Pra, elementi që i jep veçanësinë modelit poetik, bëhet edhe tipari dominant i të gjithë strukturës apo prirjes krijuese<sup>42</sup>

Njeriu i Podrimjes është i tillë për shkak rrethanave sociale dhe historike aktuale , nga ana tjetër objekti lirik i poetit shfaqet si qenie komplekse në përjetimet e tij, pasi me të vërtetë *i është rrezikuar pozita e tij ekzistenciale*<sup>43</sup>.

Podrimja dëshmon mbi karakterin ekzistencial dhe mitik të njeriut të tij, dëshmia e tij vjen në trajtën poetike në *Librin mbi të qenit* duke përcaktuar raportin me socialitetin, ku bën pjesë. Podrimja krijon një raport sa natyral aq edhe mitologjik të unit lirik me pjesën

---

<sup>41</sup> Ali Podrimja, *Vepra 1*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 8.

<sup>42</sup> Jakobson, Roman, *Language in Literature*, "The dominant", Harvard University Press, Unitet States of America, 1987, f. 41.

<sup>43</sup> Po aty, f. 332.

kolektive, ndaj sintagma “libri mbi të qenit” nënkupton dëshminë e historinë, pra edhe mitologjinë personale<sup>44</sup>.

Krijimi i asociacioneve mbi kredon poetike në shumë raste ka bërë që poezia e tij të marrë karakter “diskursiv poetik”, është momenti kur njeriu i Podrimjes nuk mund të qëndrojë pa treguar, pa folur dhe pa shpëtuar nga barra e rëndë psikologjike e kohës në të cilën kalon. Kjo është mënyra e të dëshmuarit mbi ekzistencën e njeriut të Podrimjes e cila merr formën totale në artikulimin e plotë të formës poetike; në esencë, kjo ekzistencë, në gjuhën poetike, zbulohet edhe nëpërmjet shkrimit diskursiv të poezive, ku secila poezi në shtresëzimin e idesë artikulon një ndjenjë të vuajtjes – ekzistencës së përjetuar përballë kohërave të vështira.<sup>45</sup> Kjo është mënyra me e mirë për të pasqyruar marrëdhënien e njeriut me token, pjesë e së cilës është. Ndaj poezia e Podrimjes është e ndërtuar mbi bazën e filozofisë së dashurisë për pjesën e vetvetes (tokës, prej se cilës kemi ardhur; atdheut). Në poezinë e Podrimjes nuk mungojnë edhe motivet tematike të fushës semantike të së keqes, të së ultës dhe kategorisë estetike të së shëmtuarës, ashtu siç shprehet Agim Vinca autori me vetëdije ose pa të, ka përqaftuar konceptin e estetikës motivore<sup>46</sup>.

Ky koncept është mirëfunktionalizuar për të krijuar piramidën semantike të artikulimit të raportit të pa ndarë të njeriut me hapësirën. Ligjërimi poetik i Podrimjes artikulon me tërë forcën e qenies gjuhësore ferrin e shqiptarëve në raport me kohën dhe hapësirën, në këtë të fundit ai anashkalon atë ferr Nën duke zgjedhur empirizmin e ferrit Mbi.

Ferri Mbi është një shumë ndoshta matematikore të tipit (strese, perversitete, tmerre, hipokrizi, dhunë, sofistikime, ndyrësi). Ferri Mbi i Podrimjes paraqitet me një tipar kontekstual tepër të theksuar, është ferri i njeriut, por mbi të gjitha i shqiptarit në Kosovë, i cili është i detyruar të qëndrojë përballë diskriminimit, mohimit, dhunës psiko – fizike. Ferri i shqiptarit të Kosovës është ferr i historisë së shkëlluar nga thundrat e pista: të fatit kryekeq. Historia që njeh luftë, gjak, zjarr fqinjësh, me synimin e shfarimit të shqiptarëve<sup>47</sup>.

Ferri Mbi, si siluetë të tij të kudondodhur, ka vdekjen, vdekje që kërkon viktimë nga një cep toke në një cep tjetër toke, sepse domsdoshmërisht duhet dikush të jetë pjesë e saj në një moment të ditës, patjetër që dikush nga shqiptarët të jetë pjesë. Kjo gjendje paraqitet në trajtën ndoshta më të plotë stilistike të shprehjes poetike në poezinë e Podrimjes. Vargu merr forcën e denoncimit të këtij realiteti në tërë arenën ku fjala merr formë perceptuese,

<sup>44</sup> Vehbi Miftari, *Dëshmia poetike, ekzistenciale*, Tema, 7 mars, 2009, f.14.

<sup>45</sup> Flamur Maloku, *Shtresëzimi i tekstit*, Tema, Tiranë, E diel, 9 nëntor 2008, f. 15.

<sup>46</sup> Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945 – 1980)*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 332.

<sup>47</sup> Arben Prendi, *Ferri poetik i Podrimjes*, Rilindja, Prishinë, 6 janar 1994, f. 9.

aty ku fjala jo vetëm ka forcën shprehëse por edhe memorializmin e momenteve historike per njeriun (shqiptarin).

Pavarësisht ndjenjës, rebelimit përmes ironisë, motiveve moviste të së keqes, poezia e Podrimjes nuk është poezi e dëshpërimit, të zhgënjimit, të dhimbjes, ajo është poezi e jetës mbi të gjitha, triumfit mbi vdekjen, mbi të keqen një udhërrëfyese e fuqishme e njeriut në rrugët dhe shtigjet e jetës plot me pengesa sa sociale aq edhe vetjake. Kjo karakteristikë e poezisë së Podrimjes e bën poezi të problemeve universale, duke i kapërcyer caqet e karakterit lokal kombëtar dhe duke marrë karakterin universal jo vetëm të ekzistencës njerëzore, por edhe të natyrës së njeriut si qenie shumë komplekse në vetvete. Poetika, tema, natyra e poezisë së Podrimjes e ndërlikohet jo vetëm me realitetin, por edhe me mitologjinë jo vetëm kombëtare edhe të kulturave dhe popujve të ndryshëm e bëjnë poezinë e tij të ngërthejë në vetvete një shumësi tiparësh letrare dhe artistike si të muzikës së Vagnerit, poetikës së Kafkës, të Manit, të poetikës së Jejtshit, Paundit, Herberit, konstruktit të formave dialoguese të dramave të Anouihit, Claudelit, Koktes, O’Nelit. Parë nga ky këndvështrim, krijimtaria poetike e Podrimjes, pa mëdyshje kontribuon në rrjedhat e poezisë botërore dhe për origjinalitetin shqiptar<sup>48</sup>.

### 1.3 Stilistika

Stilistika, shpesh, përdor jo kategori gjuhësore, si të tilla, por kategori të veçanta stilistike, të cilat rrjedhin, nga abstraksioni dhe kombinimi i kategorive themelore gjuhësore.

Pra, nëse duam një përshkrim sasior të një teksti, që të ketë një rrjetë të mirë për të kapur detajet gjuhësore, të cilat kontribuojnë në ndjeshmërinë e lexuesit ndaj ndryshimeve të stilit, lista e tipareve gjuhësore që duhet të numërojmë, është shumë e gjatë. Sipas studuesit Block, kërkimin për një matje tërësisht objektive të stilit duhet ta braktisim në këtë pikë, si dhe në atë për përcaktimin e shpeshtësisë së përdorimit për gjuhën në tërësi. Sigurisht, logjika e dominancës na ka udhëhequr edhe neve gjatë hulumtimit tonë, por është me interes që të shpërfaqim edhe pikëpamjen skeptike të studuesve Leech dhe Short, të cilët mendojnë se studimi i stilit as nuk mund të bazohet krejtësisht në të dhënat sasiore, as nuk mund të bëjë tërësisht pa to. Ata paraqitesin pesë argumente kundër pikëpamjes, se stili mund të përcaktohet objektivisht në bazë të shpeshtësisë së përdorimit gjuhësor në një tekst.

---

<sup>48</sup> Dorota Horodyska, *E bukura fisnikëron të vërtetën*, Rilindja, Prishtinë, E mërkurë, 21 prill 1993, f. 9.



Në dysinë *formë – përmbajtje* tingujt i takojnë formës, por kjo formë mbart në vetvete një simbolikë, që i është atribuar në kohë sipas kushteve të caktuara shoqërore, në të njëjtën kohë sipas tipareve të nyjëtimit që mbart. Në këto kushte tinguj të veçantë kanë një simbolikë të veçantë duke ia mbishtresëzuar fjalëve që ndërtojnë, e për më tepër vargut në të cilin janë pjesë e tij.

*Simbolizmi tingullor pranohet edhe si cilësi estetike e tingujve, për poetët i dhe e ngjallin përshtypjen e harresës , të lehtësisë, të qartësisë, të lirizmit; o të gjerësisë, të lartësisë dhe të hapësirës ; a të peshës, rëndësisë, u të thellësisë, errësirës e deri te frika<sup>49</sup>.*

Në poezinë e Podrimjes simbolizmi tingullor nuk është zotërues i hapësirave të mëdha, por ka raste kur haset në përdorim.

Simbolizmi tingullor duhet parë në lidhje të ngushtë me asonacën, konsonancën pasi përsëritja e një tingulli është edhe shprehje e rëndësisë së tij simbolike. Kjo është arsyeja, që në disa raste kemi shpjegimin e tingujve që përsëriten.

Në mendimin e Xhevat Lloshit vihet re një qëndrim i kufizuar mbi simbolizmin tingullor të zanoreve, edhe për zanoret jo për të gjithë zanoret e shqipes, duke lënë jashtë zanoret: y dhe ë. Në të vërtetë këto zanore mbartin një simbolikë të veçantë.

Për të parë funksionalizmin e simbolikës së tingujve le të përqijemi të analizojmë simbolizmin tingullor të disa tingujve në përsëritjen e tyre të qëllimshme në poezinë e Podrimjes.

*Ç'gurrin guri në gurinë,  
gur guri ndër gurë më i gurtë,  
gur i gurëzuar pranë gurit,  
gruth i nguruar rreth gurit,  
gurrin guri në gurë gurësh,  
guro guroje gurin në gurinë,  
ç'guri pranë gurit gur guri,  
birë e parë e fyellit tim<sup>50</sup>.*

Kjo është poezia e dytë e pjesës së dytë të poemthit *Guri* pjesë e përmbledhjes poetike *Kredo*. E gjithë poezia është ndërtuar mbi bazën e lidhjeve sintagmatike dhe paradigmatiske të fjalëve me morfemën bazë gur – i. Në leximin e parë, të gjithë lexuesit ndodhen përballë faktit të një tingullimi të pashmangshëm të tingujve: **g**, **u**, **r** dhe **rr**. Përsëritja e organizuar e këtyre tingujve, jo vetëm që krijon imazhin psikologjik të një tingullimitimi të lëvizjes së gurëve në një gurinë, por krijon ndjesinë e shkretimit të botës së gjallë, ku ekzistojnë vetëm

<sup>49</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 59.

<sup>50</sup> Ali Podrimja, *Vepra 3, Credo*, ASHAK, Alfa Print, Prishtinë, 2013, f. 179.

gurët. Në aspektin psiko-linguistik imazhet që përcillen nga tingujt e mësipërm janë të ndryshëm, por me një lidhje organike mes njërit – tjetrit. Tingulli u vjen me simbolikën që mbart, sipas Xhevat Lloshit ai është bartës i ndjesisë thellësisë, errësirës, madje deri te frika. Kjo simbolikë vjen e aktualizuar në të gjitha aspektet, një thellësi diakronike e periudhës së gurit është dëshmitare e ekzistencës, me një mistikë mbi formën, shtrirjen dhe zhvillimin e unit kolektiv të subjektit lirik. Mistika, errësirë mbi formën e ekzistencës, plotshmërinë e saj krijojnë ndjesinë e frikës mbi të panjohurën, pasi e panjohura gjithnjë ngjall frikë pohonte Karl Gustav Jungu. Pra, simbolizmi i **u – së** shfaqet me një dualitet funksionesh, si dëshmi e hershmërisë së ekzistencës në harmoni me simbolikën e gurit dhe si mungesë e dijes mbi formën e plotë të kësaj ekzistence. Tingulli g shfaqet si pjesë shoqëruese e thellësive të ekzistencës me një jehonë të madhe drejt sipërfaqes. Jehona e tij është nga lashtësia deri në ditët moderne. Psikologjikisht, kjo jehonë shkaktohet nga gurrina e gurit në gurinë. Praktikisht, **g – ja** formon asociacionin e tingullimitimit të zhurmës së shkaktuar nga lëvizja e gurëve. Nisur nga tiparet nyjetimore të tij, thellësitë i sugjeron fakti i të qenit tingull velar dhe simbolika e jehonës buron nga zëshmëria e tij. Tingulli – r bart simbolikën e lëvizjes në vazhdimësi me një butësi mbi forcën e madhe të rezistencës shkëmbore. Edhe simbolika e tij buron nga tiparet nyjetimore dhe akustike, si tingull i zëshëm, me një amplitudë të dridhjeve më të vogla se **rr – ja**, krijon imazhin e butësisë. Ndërsa, tipari i dridhjes dëshmon mbi ekzistencën në formën e pranisë. Tingulli – rr psikologjikisht krijon efektet e forcës, errësirës dhe rezistencës në botën psiko – sociale të njeriut. Një tingull i zëshëm, me një amplitudë dridhjeje dyfish se r, shfaq imazhin e qëndresës brenda në hapësirën e lindjes dhe zhvillimit (gurron). Simbolika e tij është në përputhje të plotë me simbolikën e u – së dhe me simbolikën e fjalës gur, gurinë, gurron (rrokulliset), nguruar (qëndresë, për analogji betonuar). Cila është shkalla e simbolizmit tingullor në poezinë e Din Mehmetit? Për këtë na dëshmon analiza e simbolikës së disa tingujve në strukturat vargore të poezisë së tij.

#### **1.4 Larmia e stileve në hapësirën motivuese dhe krijuese**

Poezia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit të XX karakterizohet nga një heterogjenitet stileshe e prirjesh krijuese, të cilat u zhvilluan nga disa gjenerata poetësh, me formime e ndjeshmëri të ndryshme artistike. Tiparet e brendshme evolutive të kësaj poezie, u ndikuan së tepërmi edhe nga rrethanat e jashtme, pasi hapësira shqiptare ishte e gjymtuar, dhe çdo njësi e saj shpërfaqte tipare

të veçanta letrare. Në pjesë të ndryshme të mjedisit gjuhësor e kulturor shqiptar: në Shqipërinë shtetërore, në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, tek arbëreshët e Italisë dhe nëpër vatra të diasporës u zhvilluan stile të ndryshme, madje, sipas studiuesit Bashkim Kuçuku, “këto stile ishin të skajshme deri në të kundërtën e njëri-tjetrit, megjithëse skajshmëri të tyre pati edhe në të njëjtin mjedis”<sup>51</sup>. Ndasitë mes këtyre hapësirave krijuese u thelluan veçanërisht pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, i cili ndoqi një politikë të egër ndaj të gjitha sferave jetësore dhe përmes hallkave të shumëfishta të censurës, arriti të depërtonte edhe në skutat më të thella të shpirtit krijues.

Edhe pse në kushtet e censurës politike a nacionaliste (në rastin e Kosovës), poezia mori hov të madh si në planin cilësor, ashtu edhe në atë sasior. Vetëkuptohet se dy mjediset më të mëdha të përftimit të poezisë shqipe bashkëkohore ishin Shqipëria shtetërore dhe Kosova. Ndërsa poezia e shkruar nga autorët e diasporës u kultivua në liri të plotë dhe në të shumtën e herëve, sipas gjedhes së poezisë moderne evropiane, gjë që ndikoi në pasurimin e mëtejshëm të stileve e trajtave krijuese në arealin e poezisë shqipe.

Për shkak të veçanësive të secilit mjedis krijues, edhe studimet letrare janë orientuar drejt qasjeve përndarëse mes tyre, madje në disa raste, duke mos e parë në mënyrë tërësore si një mjedis të vetëm. Kjo reflektohet edhe në sintagmat përcaktuese: “poezia e këtij kufirit”, “poezia e përtej kufirit”, “poezia e autorëve kosovarë”, etj. Përcaktime të tilla bartin në vetvete edhe vetëdijen për ekzistencën e disa sistemeve letrare (periferike), të cilat operojnë në funksion të sistemit qendror të letërsisë shqipe.

Megjithatë, duke qenë se procesi krijues i poezisë shqipe është tejet dinamik në mbarë hapësirën gjeografike të botëkrijimit dhe botëperceptimit të tij, për arsye praktike, studiuesit janë ndalur tek autorë dhe tek pjesë të veçanta të mozaikut integral të poezisë shqipe bashkëkohore. Ndonëse secila pjesë e këtij mozaiku karakterizohet nga specifikat e veta dalluese, sërish marrëdhëniet, kombinimet dhe ndikimet në funksion të tërësisë janë të pandashme. Këtë e pohon edhe studiuesi Ymer Çiraku, kur shprehet, “mund të thuhet se, ky proces letrar, në çdo kohë ka funksionuar si unitet e jo në kahje ndarëse, siç mund të jetë menduar gabimisht ndonjëherë. Pra, kemi një unitet artistik brenda diversitetit të prirjeve e stileve krijuese”<sup>52</sup>.

Pas viteve '90, mjediset letrare, të cilat ishin të ndara për shkak të rrethanave historike, u unifikuan plotësisht, duke ndërtuar një komunikim të hapur, ku përvojat krijuese u shkrinë me njëra-tjetrën.

---

<sup>51</sup> Bashkim, Kuçuku, *Antologji e poezisë shqipe bashkëkohore*, (parathënie "Larmia e madhe e stileve"), Onufri, Tiranë, 2008, f. 5.

<sup>52</sup> Ymer, Çiraku, *Poezia e gjysmës së dytë të shek. XX si hierarki vlerash, Fenomeni i Avanguardës në letërsinë shqiptare (Aktet e seminarit shkencor)*, Arbëria, Tiranë, 2004, f. 173.

## KREU II: KRITIKA LETRARE

Kritika letrare, në të kaluarën e ka trajtuar jo pak poezinë Podrimjes, e trajton edhe sot, por me siguri që do ta trajtojë edhe për një kohë të gjatë e të pacaktuar. Shkrimet për poezinë e tij mund të klasifikohen duke filluar nga ato që kanë trajtuar vetëm një poezi të tij (Agim Vinca,<sup>53</sup> Rexhep Murtez Shala<sup>54</sup> etj.), e deri te studimet monografike që merren me një vepër të vetme apo me gjithë krijimtarinë e tij (Bujar Tafa<sup>55</sup> e Jolanda Lila<sup>56</sup>).

Nga pikpamja gjuhësore realizon mes zhvendosjes kuptimore ndërtime metaforike që e lidhin ngushtësisht me fjalë të fushës semantike familjare (motër - vëlla), e më gjerë fis. Kuptimisht poetes i vjen në ndihmë krahasimi i fshehur me qyqen, që gjuhësisht vjen i stërlarguar nëpërmjet pjesëzës mohuese nuk. Zemra e origjinalitetit poetik të autorit çoket te përkthimi i metaforës. Në poezinë “Vërma emrin tim” poetja duket sikur ka ndërtuar enigmën ( për t’u zgjidhur) mes dyzimeve anaforike të realizuara me lidhëzën nëse. Koncepti i lirisë këtu ndërthuret me konceptin e njohjes, në rastin konkret , të njohjes së vetes (Unit) duke i dhënë lirisë një dimension të ri. Koncepti i lirisë si përmasë artistike realizohet drejt fluturimeve ( ka emrin e fluturimit), që duket sikur nuk mjafton dhe i jep përmasë të dyfishtë në fluturime të unit. Mes këtyre dimensioneve të lirisë poetja shfaqet si ekzistenciale, duke kapërcyer dilemën e njohjes. Gjuhësisht kjo shfaqje nuk realizohet vetëm me metaforën, por edhe mes përdorimit të foljes di, që thëllon konceptin e njohjes dhe në këtë këndvështrim metafora konceptuale vjen si e vërtetë e provuar me të vërteta absolute<sup>57</sup>.

Në lirikën e poetes sonë liria klith për lirinë. Kjo e fundit vjen si përmasë ekzistenciale, jo vetëm kur klithma poetike shndërrohet në kronikën e dhimbjes së një populli të tërë, por edhe kur pikëllima ngjizet si dhimbje e njeriut për njeriun.

Poezia lind së pari në gjakun e shpirtit të saj poetik e mandej bëhen pemë gjaku për Kosovën martire. E kundërta e lirisë, joliria ka në thelb të saj tradhëtinë, e ndaj vjen në përfytyrimin e lexuesit si një gjarpër duke na sjellë një përmasë tjetër të lirisë, por realizuar në marrëdhënien mungesore: liri/ joliri; ekzistencë, qenie/ vdekje, mohim. Në dimensionin e këtij raporti mungesa e lirisë individuale shndërrohet në zi kolektive. Kanti (1724-1804) thotë, se kusht i të gjitha lirive sociale dhe politike është detyra, obligimi për të vepruar në një mënyrë, që të mund të ngrihet në një ligj të përgjithshëm. Ekzistenca e këtyre ligjeve të përgjithshme në arsyen e njeriut shpie drejt një lirie të

<sup>53</sup> Agim Vinca, *Kënga e hapur (antologji e komentuar)*, f. 160.

<sup>54</sup> Rexhep Murtez Shala, *Analiza – kognicioni dhe modelimi*, f. 22-32.

<sup>55</sup> Bujar Tafa, *Biografemat dhe ideografemat (Lum Lumi i Ali Podrimjes)*, Universiteti AAB Riinvest, Prishtinë, 2010.

<sup>56</sup> Jolanda Lila, *Torzioni i qenies-Saga*, Prishtinë, 2011.

<sup>57</sup> Milan Kundera, *Testamentet e tradhtuara*, Tiranë, 2011, f. 112.

patjetërsueshme e të zakonshme, një realitet që mund të tematizohet, fundja vetëm në mënyrë reale.

Metafora këngë e heshtur ka ngjizur gjithë domethënien e melodive të pathëna e pakënduara, ekzistencën e tyre në shpirt ( por jo mungesën). Poetikiht e ka ndërtuar aq bukur në sintagmën aneminë e fjalës, që e përshkruan mrekullisht përjetimin mungesor të njërës prej përmasave të lirisë. Për këtë e ka ndihmuar liria e fluturimet poetike. Pranverat e saj të sosura nuk do të jenë gjë tjetër vecse një ardhje e zbehtë e lirisë së Kosovës. Koha dhe kombi zgjohen vetëm atëherë kur ndihet kënga e gruas dhe jo kur koha përkundet prej saj në djep.

## 2.1 Kritika recepsioniste

Kritika recensioniste për poezinë e Podrimjes është më vëllimorja. Kjo kritikë, e cila të shumtën e herave është shkruar me rastin e daljes në dritë të librave të tij, pothuajse gjithnjë ka mbajtur qëndrim pozitiv ndaj poezisë së këtij poeti. Përveç që ka bërë leximin dhe interpretimin e vazhdueshëm të kësaj poezie, jo rrallë në të hasen edhe tone glorifikuese e, ndonjëherë, edhe asgjësuese. Që në vitet '60, në recensionet e tyre, kritikët kanë hetuar individualitetin e tij krijues, tiparet e veçanta të poezisë dhe prirjen moderne të vargut të tij. Për poezitë e para të Podrimjes, të përmbledhura në vëllimin poetik *Thirrje*, Vehap Shita shprehet: Pa pompë e patos, pa tiradë e sentimentalitet, Podrimja është gati gjithmonë bashkëkohës dhe modern. Poezia e tij, megjithëse simbolike, është më tepër refleksive dhe përsiatëse, se sa përshkruese deskriptive dhe emotive. Vargu i tij është i gjallë, temperament; motivet janë të shumëllojshme, mendimi i qartë, i ndjeshëm, i përshkuar me njëfarë ngrohtësie të natyrshme që të ngazëllen dhe të pushton<sup>58</sup>.

Me një fjalë, Shita ia numëron të gjitha virtytet kësaj poezie, të cilat e përcollën në kohë këtë poezi. Në këtë shkrim Vehap Shita trajton tematikën e poezisë së Podrimjes, vargun e tij, figuracionin, si dhe ndikimin që kishte poezia jugosllave dhe ajo që krijohej në Shqipëri në poezinë e tij. Po në atë kohë, Rexhep Qosja deklaroi: Megjithëse relativisht i ri nga mosha, Ali Podrimja është njëri prej poetëve tanë që ka mbërritur, pak a shumë, të përvetësojë mundësinë e shprehjes moderne poetike, duke mos i keqpërdorur, në masën në të cilën iu ngjet disa të tjerëve, teknikat e ndryshme të kësaj poezie<sup>59</sup>.

Qosja, në recensionin për vëllimin poetik *Sampo*, të Podrimjes, flet për vargun dhe ritmin e kësaj poezie. Megjithëse në sy të parë poezia e Podrimjes duket e shpërqendruar në shumë tema, Qosja

---

<sup>58</sup> Vehap Shita, *Gjurmave të letërsisë*, Prishtinë, 1999, f. 388.

<sup>59</sup> Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, f. 122.

shprehet se ky poet ...ka mbërritur të përqendrojë interesimin e lexuesve rreth simbolikës së tërësisë...<sup>60</sup> dhe se *Shprehja e tij e qartë metaforike nuk reduktohet asociativisht gati asnjëherë vetëm në një drejtim, por degëzohet në drejtime të ndryshme*<sup>61</sup>.

Ai, me të drejtë, vëren se përdegëzimi i shprehjes metaforike të Podrimjes nuk ia humb unitetin kësaj poezie, të cilën e unifikon fryma që e përshkon atë. Sipas Qosjes, ajo që e dallon poezinë e Ali Podrimjes nga poezia e poetëve të tjerë të brezit të tij është prirja e tij e shmangies së deskripcionit dhe narracionit. Ali Podrimja është poet vizionar,<sup>62</sup> refreni i poezisë së tij është modern<sup>63</sup> dhe se Vargjet më të reja të Ali Podrimjes ruajnë një pastërti klasike, përfundon Qosja recensionin për poezinë e Podrimjes<sup>64</sup>.

Duke folur për poemën e Ali Podrimjes *Hija e tokës*, Hysni Hoxha veçon artin e ndërtimit të kësaj poeme: Duke e degëzuar një tematikë të këtyllë në këngë më vete, autori i është shmangur rrezikut eventual të paraqitjes së ngjarjes në një aspekt të gjerë epiko-lirik pa artikulumin e duhur shprehës dhe pa tërësinë organike<sup>65</sup>.

Ky kritik veçon stilin ekspresionist të poezisë së Ali Podrimjes. Sipas tij: *Shqetësimi i thellë, efekti kryesor i vargjeve të tilla, ngjallet në këtë rast përmes metaforikës ekspresioniste që perceptohet, pothuaj në përgjithësi vizuelisht. (.....) Edhe kur paraqet një vizion të tillë shqetësues autori shprehjen figurative e strukturon në ritmin ekspresiv, gjegjësisht në ritmin dinamik që intensifikohet me anë të përsëritjeve adekuate të fjalëve dhe segmenteve të vargut*<sup>66</sup>.

Në fund, Hysni Hoxha arrin në konkluzionin se një trajtë e tillë nuk është fryt i një perceptimi direkt dhe impresiv të realitetit objektiv, por vizion i brendshëm, respektivisht, realitet i brendshëm i krijuar në bazë të intuitës së poetit.<sup>67</sup> Për një kritik tjetër, Ibrahim Rugovën, vëllimi poetik *Torzo* është fakt i rëndësishëm letrar,<sup>68</sup> për të, me këtë libër të tij Ali Podrimja e arrin standardizimin e poezisë së tij, do të thotë të tekstit poetik<sup>69</sup> ...i gjithë libri i poezisë përbën një nivel të përbashkët, ku çdo varg dhe çdo poezi është krijuar në atë mënyrë që të qëndrojë në pavarësi të tërësisë, e vazhdimisht në kuadër të tërësisë. Pra, këtu kemi të bëjmë me tendencën që çdo poezi e librit të jetë poezi më vete, një mikrobotë që ekziston dhe flet vetë<sup>70</sup>.

---

<sup>60</sup> Po aty, f.122.

<sup>61</sup> Po aty, f. 123.

<sup>62</sup> Po aty, f. 127.

<sup>63</sup> Po aty, f. 127.

<sup>64</sup> Po aty, f. 126.

<sup>65</sup> Hysni Hoxha, *Kritika*, f. 91.

<sup>66</sup> Po aty, f. 98.

<sup>67</sup> Po aty, f. 98.

<sup>68</sup> Ibrahim Rugova, *Strategjia e kuptimit*, f. 81.

<sup>69</sup> Po aty, f. 82.

<sup>70</sup> Po aty, f. 82.

Rugova në këtë recension flet për idenë e poezive, gjuhën, për ironinë e shprehjes poetike etj. Ndërkaq, Anton Nikë Berishaj, në recensionin për vëllimin poetik *Sampo 2*, shprehet se ...ekzistimi, qëndresa, veprimi, një shqetësim permanent dhe i ndieshëm, një ironi dhe një revoltë poetike e disa nga problemet qenësore jetësore – të shprehura nëpërmjet një ligjërimi poetik të ngritur – këto e cilësojnë përmbledhjen e Ali Podrimjes “Sampo 2”<sup>71</sup>.

Ndërsa sa i përket mesazhit të pozisë së Podrimjes, Berisha thotë se këtë mezat ...e cilëson revolta dhe ironia e ngritur – një revoltë dhe ironi e prerë dhe e ashpër kurdoherë e pasur dhe e dalë natyrshëm nga strukturimi tërësor tekstual dhe konteksti i begatshëm pateologjik<sup>72</sup>.

Për një kritik tjetër, Abdullah Konushevcin, poezia e Podrimjes është poezi e sintaksës së lashtë. Për të, figura e Podrimjes në historinë e letërsisë shqipe është një fenomen tejet kompleks, sepse, si të rrallë ndonjë poet tjetër yni, procesi i evoluimit krijues, përkatësisht i përcaktimit të tij, del i koklavitur dhe me vështirësi mund të ndiqet, jo pse poezia e tij nuk ka kontinuitet të shënueshëm, jo pse Ali Podrimja nuk paraqet një personalitet të fuqishëm poetik, por pse nga libri në libër, të shumtën e herës, shënohet një “kërcim” kualitativ, që e bën të diskutueshëm punën e kontinuitetit dhe diskontinuitetit të poezisë së tij<sup>73</sup>.

Sipas Konushevcit, krijuesit që kanë ndikuar në poezinë e Podrimjes, janë Migjeni e Mekuli, ndërkaq e krahason me simbolistin irlandez, Jejts. Ndërsa, kur shkruan për vëllimin poetik *Zari*, Konushevcit me të drejtë konkludon: ...poezia më e re e Ali Podrimjes është përsëri poezi e revoltës dhe e protestës së artikuluar fuqishëm kundër padrejtësisë jo vetëm sociale, por edhe njerëzore, në të cilën spikat angazhimi për t’u lakmuar intelektual, që e përshkon tërë librin<sup>74</sup>.

Megjithatë, marrë nga ta marrësh, lajtmotiv i poezisë së A. Podrimjes është dhe mbetet fati, ekzistenca kombëtare, madje edhe kur ligjëron për tema e motive, në të parë, të largëta,<sup>75</sup> përfundon Konushevcit. Moment i veçantë në krijimtarinë e Ali Podrimjes, dhe jo vetëm të tij, por edhe të poezisë së sotme shqipe, është botimi i vëllimit poetik *Lum Lumi* (1982). Me botimin e këtij vëllimi, poezia e tij për herë të parë strukturohet në atë mënyrë sa merr formën e poemës; jo nga përmbajtja, por nga fryma që e përshkon atë. Për këtë vëllim, që me botimin e tij, kritika dha vlerësimet më të larta që mund t’i bëhen një libri. Por, duhet të theksojmë se ky vëllim është ndër të rrallët që vazhdon t’u qëndrojnë vlerësimeve të para, ashtu siç vazhdon t’i bëjë ballë edhe kohës, e cila jo rrallë i kalon në harresë krijesat poetike të zakonshme. Për Mensur Raifin, vëllimi poetik *Lum*

---

<sup>71</sup> Anton Berisha, *Teksti poetik*, f. 65.

<sup>72</sup> Po aty, f. 66.

<sup>73</sup> Abdullah Konushevcit, *Për poezinë*, f. 55.

<sup>74</sup> Abdullah Konushevcit, f. 66.

<sup>75</sup> Abdullah Konushevcit, f. 70.

*Lumi* është meditim poetik mbi jetën dhe vdekjen që s'mbahet mend me fuqi dhe bukuri të thënies e shprehjes në poezinë shqipe që nga fillimet e deri më sot<sup>76</sup>.

Vdekja, kjo temë e stëreksploruar në historinë e mendimit njerëzor, këtu konceptohet si katarzë, kalitje dhe kushtrim (kush-a-trim)<sup>77</sup>.

Në kacafytjen e këngës me vdekjen ngadhënjën krijimtaria, sepse ...vdekja nuk është vdekje por lindje e vlerave të reja, të njëmendëta, njerëzore, se mizoria e infektiveve, e rendit shtëpiak, e duarve të ftohta, kjo ironi e jetës kthehet e bëhet jetë, durim e qëndresë<sup>78</sup>.

Sipas Raifit, në vëllimin poetik *Lum Lumi* ...afazia e poezisë shndërrohet në mit dhe miti është lindje e re, poezi<sup>79</sup>.

Ndërsa për Anton Berishën, poezia e vëllimit *Lum Lumi* të Ali Podrimjes nuk — ...është vetëm verifikim i nivelit të poezisë së këtij poeti, por njëherit verifikim i nivelit cilësor artistik që ka arritur poezia shqipe në përgjithësi<sup>80</sup>.

Kjo poezi shpreh esencën e një vetëdijeje estetike, ndërsa me elementin që ngërthen, ...lidhet dhe ngritet në nivelin poetik evropian<sup>81</sup>.

Për Berishën, Poezia e Ali Podrimjes shpreh në esencë poetikën e të qenmes, të ekzistencës së njeriut, që është koncepti themelor i objektit të saj artistik. Me poetikën e të qenmes këtu duhet nënkuptuar faktin se poeti nëpërmjet të të folurit poetik e shqipton, përkatësisht e krijonn atë të qenme, atë poetikë<sup>82</sup>.

Berisha flet për strukturën e vëllimit poetik *Lum Lumi*, për ligjërimin poetik, stilin poetik dhe vetëdijen estetike. Stili poetik i Podrimjes konstituohet e determinohet nëpërmjet të mesazhit specifik artistik, ku dalin në shesh refleksione të thella të ironisë, të absurdit, të protestës<sup>83</sup>.

Si kritika recensioniste, ashtu edhe kritikant tjerë, kur është fjala për kryeveprën e Podrimjes *Lum Lumi* bashkohen në vlerësime. Basri Çapriqi, kur është fjala për këtë vëllim poetik dhe poezinë e Podrimjes në përgjithësi, përfundon se Libri "*Lum Lumi*" dhe poezia që ky autor krijon gjatë viteve '80 është një shmangie stilistike, si rezultat i kredos së tij krijuese për të sjellë vazhdimisht diçka të re në skenën letrare<sup>84</sup>.

---

<sup>76</sup> Mensur Raifi, *Mozaik letrar I*, f. 119.

<sup>77</sup> Mensur Raifi, f. 120.

<sup>78</sup> Mensur Raifi, f. 120.

<sup>79</sup> Mensur Raifi, f. 120.

<sup>80</sup> Anton Berisha, *Teksti poetik*, f. 82.

<sup>81</sup> Anton Berisha, f. 82.

<sup>82</sup> Anton Berisha, vep. cit., f. 82.

<sup>83</sup> Po aty, f. 85.

<sup>84</sup> Basri, Çapriqi, *Simboli dhe rivalët e tij*, f. 153.



## 2.2 Kritika e introduktave

Kritika introduktive shkon një hap më tej kritikës recensioniste, sepse ajo trajton jo një vepër të veçantë të autorit, por një përzgjedhje poezish të tij nga vepra të ndryshme. Nga kjo lloj kritike kemi zgjedhur parathënien e poezive të zgjedhura nga Bashkim Kuçuku, botim i —*Toenës* më 2002. Në këtë shkrim të gjatë për poezinë e Podrimjes,<sup>85</sup> Kuçuku flet për gjeografinë kombëtare në poezinë e poetit, për përmasën kombëtare të saj, për hartën historike të atdheut në këtë poezi, për hartën poetike dhe të etnisë, për vetëdijen kombëtare mbi atë poetike, pastaj për anën formale, figuracionin etj. Duke u marrë me vlerat e saj të jashtme, në këtë parathënie të poezisë së zgjedhur të Podrimjes, sikur ngelen nën hije vlerat e saj ideo-estetike dhe struktura e saj. Kuçuku, sikur e tepron duke kërkuar prapa çdo fjale të poezisë së Podrimjes alegori politike e patriotike, si poezi me të cilat poeti i kundërpërgjigjet demagogjisë së ideologjisë së kohës. Nëse kjo alegori në poezinë e Podrimjes ishte aktive në rrafshin historik, në atë bashkëkohor sikur është mjaft e kujdesshme (është fjala për vitet '60 e '70), sepse poezia e kësaj kohe në prapavijë kishte premisat e ideologjisë së kohës, e cila edhe e mbështeste atë ideologji. Raportet e krijimtarisë me kohën, me ideologjinë, sidomos gjatë sundimit të ideologjisë moniste, jo vetëm të Ali Podrimjes, janë më komplekse, ndërsa Kuçuku sikur i thjeshtëzon ato.

## 2.3 Kritika studimore

Për krijimtarinë e Ali Podrimjes u shkruan edhe kritika studimore, në mesin e të cilave hyn shkrimi i Agim Vincës në monografinë *Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)*, i Basri Çapriqit në librin *Simboli dhe rivalët e tij*, i Bavjola Shatros në *Fjala dhe ontologjia*, pastaj ai në librin *Historia e letërsisë shqiptare* të Elsit etj. Ndër studiuesit që janë marrë më së shumti me poezinë e Ali Podrimjes është Agim Vinca. Interesimi i tij për poezinë e Podrimjes është i hershëm. Ai, përveç recensioneve që ka shkruar për vepra të veçanta të Podrimjes, krijimtarinë e tij e ka shqyrtuar gjerësisht në monografinë studimore deri më tani më të plotë për poezinë e sotme shqipe-*Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)*. Zakonisht, kritikët kur flasin për poezinë e Podrimjes, veçojnë si fazë të pjekurisë së saj vëllimin e tij poetik Sampo (1969). Këtë fazë të krijimtarisë së Podrimjes, që fillon pas tri vëllimeve të para të tij: *Thirrje*, *Shamijat* e *përshëndetjeve* dhe poema-*Hija e tokës*, Vinca e emërton si fazë simboliste në poezinë e tij, si fazë të kalimit nga

---

<sup>85</sup> Bashkim, Kuçuku, *Parathënia e librit, Litari i ankthit*, Toena, Tiranë, 2002.

alegoria, — në simbol e ironi, elemente këto që e përcaktojnë strukturën e pjesës dërrmuese të vjershave të vëllimit “Torzo”, “Folja” dhe “Credo”<sup>86</sup>.

Sipas Vincës, njeriu të cilit i këndon Podrimja është njeri tek i cili mbizotëron ndjenja e përjetimit tragjik të realitetit. — Kjo është njëra ndër arsyet që poezia e Podrimjes – veçanërisht prej përmbledhjes “Torzo” e këndeje – merret kryesisht me fenomenin e së keqes, së ultës dhe së shëmtuarës, duke përqaftuar kështu, me vetëdije ose pa të, konceptin e “estetikës moviste”, siç do të thoshte Alfred Uçi<sup>87</sup>.

Në fund, duhet të theksojmë se në veprën e Vincës krijimtaria e Podrimjes është trajtuar deri në vitin 1980, ndërsa jashtë saj kanë ngelur edhe tri dekada të krijimtarisë së poetit. Poezinë e Podrimjes, në studimin *Teori e poezisë shqipe në Jugosllavi*, Ibrahim Rugova e fut në kuadër të poezisë subjektive, si poezi e hermetizmit lirik, sipas tij të një hermetizmi të veçantë, si hermetizëm lirik e jo në vështrimin ideologjizues: *...fenomenin e hermetizmit mund ta marrin në vështrim të drejtë si mbyllje të subjektit poetik në planin e relacioneve me botën në vështrim kauzal, e kursesit në atë konceptual, sepse në poezi shfaqet si aktivitet mjaft intensiv poetik*<sup>88</sup>.

Shenjat e para të një kërkese për rishqyrtimin e subjektit, të brendisë së individit, të njeriut, i gjejmë që në fillimet e kësaj poezie<sup>89</sup> (përmend poetët që nga E. Gjerqeku, D. Mehmeti, Rr. Dedaj etj). Refleksioni lirik i kësaj poezie realizohet edhe përmes një sistemi figurativ, i cili nuk e përmban konceptin e figurës së tërësishme si konceptin poetik, po më shumë si figuracion analogjik e identifikues me objektet e idetë sinjifikuese<sup>90</sup>.

Ali Podrimja me poezinë e tij të mëparshme deri në vitet ‘70 inkuadrohet në një element të poezisë subjektive – në revoltën lirike poetike, që përfundon me librin “Sampo” (1969), kurse me librin “Torzo” (1971), do të inkuadrohet plotësisht në poezinë objektive me ironinë e tij poetike. Me këtë libër edhe e arrin standardin e poezisë së vet, që do të vazhdojë edhe me librat e tjerë. Po ashtu shquhet edhe për nacionalitetin dhe ekonominë e shkrimit poetik me çfarë do të ketë ndikim të dukshëm në poezinë e kohëve të fundit. Është poet që ka arritur t’u përballojë ndryshimeve poetike që i ka iniciuar e konsoliduar<sup>91</sup>.

Nga tetë vëllimet poetike të Ali Podrimjes, në studimin *Teori e poezisë shqipe në Jugosllavi*, në të cilin të gjitha librat e trajtuara i rangon në pesë grupe: Libër i dobët, Libër i zakonshëm, Libër interesant, Libër i mirë dhe Libër i mirë e me ndikim, Ibrahim Rugova tre i rangon në shkallën e dytë: Libër i

<sup>86</sup> Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980)*, f. 331-332.

<sup>87</sup> Po aty, f. 334.

<sup>88</sup> Ibrahim Rugova, *Strategjia e kuptimit*, f. 178.

<sup>89</sup> Po aty, f. 178.

<sup>90</sup> Po aty, f. 180.

<sup>91</sup> Po aty, f. 200-201.

zakonshëm, (Shamijat e përshëndetjeve, Dhimbë e bukur, Hija e tokës), një në shkallën e tretë *Libër interesant* (Sampo), një në *Libër interesant për kohën* (Thirrje), një *Libër i mirë*, interesant e me ndikim (Torzo), dy në *Libër interesant e me ndikim* (Folja, Credo), që do të thotë se pesë prej tyre i rangon lart. Megjithatë, kur është fjala për librat e Podrimjes, Rugova sikur nuk u përmbahet shkallëve të rangimit. Vlerësimi i tri vëllimeve si: *Libër interesant për kohën*, *Libër interesant e me ndikim* dhe *Libër i mirë, interesant e me ndikim*, del jashtë klasifikimeve të paraqitura në libër, sepse nuk ka të tillë klasifikimi, por kombinime nga shkallët që i paraqet aty. Për Robert Elsie, vëllimi poetik *Lum Lumi* (1982), i Ali Podrimjes-shënoi një moment kthese në poezinë e sotme kosovare. Sipas Elsit, homazhi që i bën Lumit, djalit që i vdiq solli një preokupim ekzistencialist me dilemën e qenies, me elemente të vetmisë, frikës, vdekjes dhe fatit<sup>92</sup>.

Poezinë e ka të ngjeshur e të lidhur në strukturë, kurse figuracionin konkret, shprehës e pa fjalamani prolikse artificiale. Çdo fjalë ka funksionin e vet. Çka e mahnit lexuesin shqiptar është mjeshtëria e lartë për të stolitur këtë peizazh shkëmbor të kursyer, që të kujton folklorin shqiptar, me metafora të pazakonta, struktura sintaksore të befta dhe rima të gjetura<sup>93</sup>.

Basri Çapriqi duke e ndarë në faza poezinë e Podrimjes, poezinë e tij të viteve '70 e quan si fazë të ekonomizimit maksimal të shprehjes dhe të komunikativitetit të vështirësuar. Në këtë fazë — Autori lë një traditë shkrimi, bën shmangie të madhe stilistike dhe me shmangien e vet bën që të krijohet një shmangie e madhe në poezinë shqipe në përgjithësi<sup>94</sup>.

Sipas Çapriqit, në këtë fazë Ali Podrimja lë pozicionimin ndërtues autorial të folësit dhe kalon në pozicionimin joautorial çrëndomtësues e dekompozues. Sa i përket komunikimit të poezisë së Podrimjes me lexuesin, Çapriqi thekson se poezia e Podrimjes ka komunikuar, madje edhe atëherë kur i kanë munguar skajshmërisht shenjat lokale. Këto vepra që u shkruan për poezinë e Podrimjes, ose në të cilat ka shkrime studimore për poezinë e Podrimjes, janë të kufizuara, sepse në to është trajtuar krijimtaria e poetit deri në kohën kur këto u shkruan, pra ato janë të përqendruara në disa vepra të tij e jo në korpusin letrar të Podrimjes.

---

<sup>92</sup> Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 453.

<sup>93</sup> Robert Elsie, vep. cit., f. 454.

<sup>94</sup> Basri, Çapriqi, *Simboli dhe rivalët e tij*, f. 151.

## KREU III: Vendi që zë vepra e Ali Podrimjes

### 3.1 Në libra shkollorë

Studiuesi Roland Zisi, në librin *Letërsia bashkëkohore shqiptare* (poezia), merret me tematikën e poezisë së Podrimjes, me motivet e saj dhe poetikën. Për tematikën atdhetare: Në krijimtarinë e frymëzuar e të shkruar me këtë tematikë, poeti kombinon në një aksion të vetëm poetik një varg shenjash individuale, familjare, shoqërore, historike, gjeografike e kulturore të botës shqiptare, të cilat synojnë evokimin e etnisë dhe të atdheut<sup>95</sup>.

Ndërsa, duke filluar me vëllimin “Sampo”, vëllim që u duartrokit nga kritika e lexuesi mbarëshqiptar, Podrimja, i propozon lexuesit një poezi të re, moderne, filozofike dhe kryesisht metafizike<sup>96</sup>.

Në librat e mëvonshëm Podrimja spikat për aktivizimin e një metafore të pasur dhe energjike, të një gjuhe ironike e groteske, por mbi të gjitha për krijimin e sistemit poetik që mbështetet tek simboli<sup>97</sup>.

Sipas tij, poezia e Podrimjes kthehet tërësisht në një krijimtari neosimboliste apo postsimboliste, madje edhe titujt e përmbledhjeve rrezatojnë semantikën simbolike, nënkuptuese e sugjeruese.... Pastaj në libra shkollorë, për klasat e fundit të shkollave të mesme (Ali Aliu e Agim Vinca).

### 3.2 Në monografi

Deri më tani për poezinë e Ali Podrimjes janë botuar dy studime monografike, e Bujar Tafës —Biografemat dhe ideografemat (Lum Lumi i Ali Podrimjes) dhe ajo e Jolanda Lilës *Torzioni i qenies* (Simbolet mitologjike në poezinë e Ali Podrimjes). Bujar Tafa, në këtë monografi, studion vetëm variantet e vëllimit poetik *Lum Lumi*, që e kufizon studimin e tij. Ndërkaq, Jolanda Lila studion simbolet mitologjike në poezinë e Podrimjes, por jo duke u nisur nga vëllimi i tij i parë e deri tek i fundit, por duke u mbështetur vetëm në një libër me poezi të zgjedhura, siç është *Litari i ankthit*, Toena, Tiranë 2002). Një gjë e tillë ia pamundëson studiueses të kuptojë ndërlidhjen e këtyre figurave me fazat nëpër të cilat ka kaluar poezia e këtij poeti, por edhe ndërlidhja e kësaj poezie me kohën në të cilën është krijuar. Ali Podrimja ka krijuar poezi përgjatë gjysmë shekullit, kohë në të cilën poezia e tij ka evoluuar, është transformuar, por edhe poeti dhe populli i tij kanë kaluar nëpër rrethana të ndryshme. Këto, studiuesja nuk arrin t'i ketë parasysht në studimin e saj.

<sup>95</sup> Roland Zisi, *Letërsia bashkëkohore shqiptare* (poezia), Tiranë, 2008, f. 201.

<sup>96</sup> Po aty, f. 202.

<sup>97</sup> Po aty, f. 203.

## **KREU IV: Vlerësimi mbi personalitetin Ali Podrimja**

Ka personalitete të kulturës sonë që, me kompleksitetin e veprës së tyre dhe, duke qenë pjesë e pandarë e jetës sonë shpirtërore, e bëjnë të vështirë ripërsëritjen e atyre vlerësimeve që ata kanë marrë nga lexuesi i tyre, nga qytetari i thjeshtë, nga çdo shqiptar, që ndjek prej vitesh vlerat dhe figurat morale të këtyre personave. Vështirësia, në rastin e vlerësimit kompleks të shkrimtarit, intelektualit të shquar Ali Podrimja, vjen prej faktit se çdo gjë që të thuhet sot duket se është gjithnjë e njohur, se kudo dhe kurdo ne kemi ndjekur një figurë me vlera të spikatura, si në fushën e letërsisë, ashtu dhe në jetën morale e sociale.

Është pikërisht Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” që ndërton drejtpërdrejt, por edhe tërthorazi, një sistem vlerash origjinale, si të sferës letrare, ashtu dhe të sferës moralo-shoqërore.

Së pari, Ali Podrimja është ndër ata shkrimtarë që ka qenë edhe mbetet pjesë e pandarë e gjithë procesit mësimor të shkollave, por edhe të universiteteve shqiptare. Krijimtaria e tij letrare, që prej fillimeve të saj e deri në ditët e sotme, është bërë pjesë shpirtërore e gjithë lexuesve, studentëve të drejtimeve dhe specialiteteve të ndryshme. Në aspektin e formimit humanitar vepra e Ali Podrimjes është në grupin e shkrimtarëve më të preferuar. Krijimtaria e tij letrare ka përcjellë në shkollat tona, të të gjitha niveleve, ide dhe parime morale, që kanë të bëjnë me formimin shpirtëror të brezit të ri, me vlerësimin e aspekteve të tilla formuese, që përbëjnë bazën e ndërtimit të një shoqërie të shëndetshme, që ka parime në konceptimin e jetës së individit, dhe të gjithë shoqërisë. Proza dhe sidomos poezia e Ali Podrimjaes ka reflektuar vazhdimisht ndjesi të fuqishme të dashurisë për vendin, për të ndershmen, për raporte njerëzore midis njerëzve, për sinqeritetin dhe ndershmërinë e komunikimit. Vepra e Podrimjes, duke qenë në grupin e autorëve më të shquar të letërsisë shqiptare, përcjell gjithnjë mesazhe njerëzore, parime të një morali dhe marrëdhënieje të qytetëruar. Përmes një komunikimi origjinal, herë përmes humorit, herë përmes dëshpërimit njerëzor, herë përmes afirmimit të idealeve sociale, shkrimtari ynë ndërton një marrëdhënie krejt të veçantë me shqiptarët e tij, ku mbizotëron, nga njera anë thjeshtësia, mënyra e drejtpërdrejtë e shprehjes, nga ana tjetër filozofia e thellë njerëzore mbi thelbin e jetës dhe të njeriut. Është pikërisht kjo filozofi e brendshme, që vjen thjesht e pa bujë, që depërton në shpirtin tonë. Kështu studentët e universiteteve tona, në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe të tërthortë, përthithin filozofinë jetësore ashtu thjesht, por thellësisht të prekshme. Dhe ne e dimë se një autor pëlqehet, bëhet pjesë e jetës sonë shpirtërore, atëherë, kur tërthorazi ai godet në thellësitë e ndjenjave; ne buzëqeshim, vrejtemi, mrekullohemi sepse Podrimja arrin të na pushtojë pa u ndjerë. Prandaj një ndër arsyt që Universiteti ndjen detyrimin moral për ta vlerësuar këtë personalitet të kulturës është marrëdhënia aq njerëzore që ka ndërtuar prej vitesh, me botën shpirtërore të rinisë sonë, në të gjitha nivelet e

arsimimit të saj. Arsyeja e dytë, që unë mendoj se vlerësimi me këtë çmim është një detyrim moral i universiteteve tona, ka të bëjë me modelin që përcjell krijimtaria e këtij autori lidhur me vlerat e pashtershme të përdorimit të fjalës shqipe. Studentët dhe nxënësit e të gjithë niveleve kanë gjetur në prozën dhe poezinë e Podrimjes dashurinë për gjuhën shqipe, intuitën e përdorimit të saj në mundësitë e brendshme të pafund, përzierjen mjeshtërore të leksikut të hapësirave të gjera. Kjo i ka zbuluar atyre vlerat e gjuhës shqipe, sidomos në spontanitetin e shprehjes së ndjenjave më të thjeshta njerëzore, komunikuar shpesh përmes një humori të këndshëm. Kjo i ka dhënë ligjërimin të Podrimjes një forcë të brendshme komunikuese dhe depërtimi në shpirtin njerëzor. Arsyeja e tretë, që unë mendoj se vlerësimi me këtë çmim është një detyrim moral i universiteteve tona, ka të bëjë me filozofinë e lidhjes së veprës së këtij personaliteti me misionin dhe figurën e tij në zhvillimet ideore e sociale të shoqërisë sonë. Një mendje e hapur, e pakompromentuar, një kurajo qytetare që pozicionohet ndershëm në problematikën shqiptare, jashtë komplekseve të përshtatjes apo interesit të ngushtë personal, besnik i ndershëm i ideve që e udhëheqin në jetë, mendimtar i urtë, që synon të shkojë përtej situatave konfliktuale, që synon të ndikojë me largpamësi në zhvillimet e vendit të tij, etj. Dhe të gjitha këto qëndrime, nuk kanë asgjë të përbashkët me bujën mediatike, me kompleksin e të dukurit sa më interesant dhe dogmatik. Ali Podrimja ka sjellë një model të ri, thellësisht origjinal, të papërsëritshëm, të komunikimit mediatik dhe bisedor: thjeshtësinë, shprehjen e drejtpërdrejtë, humorin e vetvetishëm, ndaj të cilit askush nuk mund të mbetet indiferent. Kjo mënyrë e drejtpërdrejtë, që ka në themel besnikërinë ndaj një morali të ndershëm njerëzor, është modeli më i suksesshëm për formimin e brezave të rinj, që sidomos në realitetet e sotme, duhet të gjejnë brenda vetes vlerat e vërteta, parimet e moralshme, mbi bazën e të cilave duhet të ndërtojnë marrëdhëniet e gjata me shoqërinë shqiptare, por në radhë të parë edhe me vetveten.

Ali Podrimja bën pjesë në bërthamën e poetëve që hyjnë në letërsinë shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX dhe që me dhimbje dhe mundime prometeiane hap udhën për një zhvillim të fuqishëm të poezisë sonë<sup>98</sup>.

Ky poet botën e vet poetike e artikulon përmes një sistemi të mirëndërtuar figurativ (spikasin simboli dhe metafora), ku ndjehet shkalla e lartë e ndjeshmërisë. *Ti na qenke ajo ura që në heshtje të vdekshme të kohërave të sërta,/kënduar të ka im atë Bjeshkëve të namuna e krahasuar me Urë të Shenjtë Urë moj Urë e Artës /Deri te guri yt i latuar nga mjeshtri epirotas/ Udhë bëra vite e vite... Lumit tim sa vjet i duhen /Nëpër ty të kalojë me një lulëkuqe në dorë.* Njësitë ligjëruese të Podrimjes hartografojnë jo vetëm shtrirjen e individit në kohë, por gjithë dramën e historisë së tij, të historisë si

---

<sup>98</sup> Fatos Arapi, *Në kërkim të lirisë, atdheut, njeriut*, parathënie e vëllimit poetik: "Libri mbi të qenit të Ali Podrimjes", Kosova Pen Center, Prishtinë, 2009, f. 5.

qenie në raport me veten, në raport me tokën e tij, po ashtu edhe në raport me të tjerët. Podrimja shqipton me forcë të madhe dramën e shqiptarit jashtë trungut mëmë, duke e shndërruar poezinë e tij, në jo pak raste, në poezi të dramës së vazhdueshme, në poezi të peshës së rëndë të fatit, të fatit të tokës së tyre Kosovës. Metaforat konceptuale shenjojnë një numër të madh të koncepteve abstrakte. Metafora ka qenë mjet i fuqishëm për të krijuar botën konceptuale poetike të mohuar në të vërtetë, atë që i mungoi Podrimjes, vendlindjen etnike ai e krijoi përmes metaforës. Ai konceptualizoi dhimbjen, dashurinë, durimin duke i vendosur në kohë dhe në hapësirë pa shprishur rrjedhën e universalizmit hapësinor të tyre, madje metafora i shërbeu për të kapërcyer hapësira në përballimin e dhimbjes, në shprehjen e dashurisë duke bërë përgjithësime konceptuale të këtyre ndjesive.

*E ai mendonte kurse një sharrë thyer buzë lumit yjt numronte yjt e ftohtë të pikëllimit.*

Ligjërimi konceptual faktin shumëplanësinë e shprehjes si dëshmi e pasurimit semantik të gjuhës. Metafora krijon struktura në mungesë formale dhe në prezencë konceptuale: *E fyelli këndon pa i rënë kush*. Konstrukti metaforik i mësipërm, ngërthen në vetvete marrëdhënie semantike të dy simboleve të ekzistencës kombëtare, të grupit simbolik të trashëgimisë shpirtërore dhe kombëtare.

*Njerëzit shkojnë e vijnë një fjalë se thonë e fyelli këndon pa i rënë kush./ dielli fle në guskën e një ëndrre. Nëpër dritaren e verbuar të heshtjes së zgurdulluar.*

*Koka e dorës së shtatë më shtrëngon në fyt/ Në shpirt një gjarpër ma lëshon shiu dhjetë vjet bie në një legjendë; Gjuha e nxirë e tymit.*

Kuptimësia është e shtrirë në të gjitha njësitë gjuhësore ashtu siç pohon edhe John Lynos kur mendon se: “Kuptimi tërësor gjuhësor i një shprehje përbëhet nga kuptimet leksikore të fjalëve dhe këtyre kuptimeve strukturore.... Aparati me të cilin shpjegohen kuptimet strukturore përbën gramatikën e gjuhës”.

## 4.1 LUM LUMI

Ali Podrimja, te kryevepra e tij, Lum Lumi (1982), në tekstet e rralla personale, ashtu siç do e bën letërsia moderne, universalizon kontekstin personal, referencat e rënda të jetës, tragjedinë e humbjes së djalit e dhimbjen që s'mbaron kurrë. Kjo poezinë e tij personale e bën universale, dhimbjen e babës, dhimbje që mbështjell universin, rrëfimin e dhimbjes, figurë që shenjon jetën. Teksti i prerë në blloqe të një kronike që shoqëron sëmundjen e djalit hapet i ftohtë e i zyrtë, shenja që bëjnë ontos-in e tij. Ky ontos na largon nga referencat e para të shkrimit e të dhimbjes, drejt dhimbjes që hapet në leximin e secilit, qoftë dhe kur lexuesi s'e njeh kontekstin personal të veprës

së Podrimjes. Shenjat e mëdha letrare e emocionale, Lum Lumin e çojnë në katrorin e elegjisë, që kryqëzohet me dhimbjen. Por gjëma nuk ndihet në zë, meqë shtrihet në figura, në zymtësinë e diskursit, në paradoksin e shkrimit që do ta zbrazë dhimbjen kur e shkruan duke i fshehur figurat. Hapjen më të madhe gjëma e Podrimjen e ka kur zbulohen figurat ambientale, të cilat janë plot me kulturën fatidike të vajit e të gjëmës shqiptare. Këto shenja sikur duan të thonë se letërsia si kjo e Podrimjes ruan iluzionin për ta bërë dhimbjen kulturë, kur e shkruan atë si kulturë. Nëse e pakëson kur e shkruan, tepër e vështirë të thuhet e të shkruhet. Në anën tjetër, tradita tridhjetëvjeçare e leximit të kësaj vepre, paprerë e ka parë atë në kontekstin personal e nën shenjat e së vërtetës së jetës së Podrimjes. Tema e rëndë dhe fara personale e literaturës leximin e tillë e kanë lidhur me biografinë, që, vërtet, është një lidhje me kontekstin personal të autorit, pa e zbritur në lexime sociale e ideologjike. Duket hapur në leximet me shkrim të Lum Lumit se vepra e ka transmetuar fort zinë e dhimbjen e shkruar, madje të jetuar. Lum Lumi ka katër cikle. I dyti, Të jetosh, është më i bukuri poetikisht e më i rëndi tematikisht. Ai është një perlë e zezë e veprës, ndërtuar nga poezitë për Lumin e përfshirë në qerthullin e vdekjes. Lumi e kapërcen këtë kufi, “derdhet” tej, ndërsa baba/poeti e provon vdekjen për së gjalli. Figurat e Podrimjes te ky cikël burojnë nga emocioni, nga dhimbja. Kur hapet figura, takohet emocioni e njihet thellë dhimbja. E shoqëruar nga një fatalitet pa rrugë të dytë, figura e Podrimjes merr shenjën e një figure mitike. Vaji i Podrimjes bëhet vaj i qyqes, si në etosin e dhimbshëm shqiptar. Figura e tillë s’është dekor i temës e i strukturës, por esencë e tyre. Kur lexohet figura, lexohet zemra e qerthujve semantikë të poezisë së Ali Podrimjes. Lum Lumi i bashkohet rrjetit të elegjive për njerëzit e dashur, të shkruara kudo e në çdo kohë. Por si të gjitha veprat e tilla, Lum Lumi e provon se askush nuk mund të vajtojë për Lumin si Ali Podrimja. Kjo vepër vetëm përjetohet nga të tjerët, më shumë a më pak, në leximet e secilit. Ajo hapet me frymën e me zinë e saj para shpirtit që ndjen. Emocioniet e rënda reflektojnë ide të rënda, që, përtej racios, nisen drejt shpirtit të lexuesit. Kush e lexon Lum Lumin i hyn aventurës së rëndë për ta njohur Ali Podrimjen, gurët e rëndë të jetës së tij, frymën e dhimbjen, Ali Podrimjen e kthyer nga vetja, madje njëjën universale të poezisë së tij. Kthimi nga vetja është hyrje në vetënjohje, shpalim i qenies në ontos poetik, në një estetikë të rrallë, që e rrallë është edhe pse tekstin e bën quid unicum, një ontos të cilit i mjafton vetja e hapet për të tjerët. Në këtë estetikë, leximet më autentike janë ato të teksteve pa kontekste<sup>99</sup>.

---

<sup>99</sup> ASHAK, *STUDIME-Revistë për studime filologjike* Prishtinë, 2014, f. 187.



## PËRFUNDIME:

Ali Podrimja poeti i Kosovës i cili në fillim të viteve dyzet të shekullit të kaluar, zhvillon një betejë dramatike të pasosur: janë fati dhe fatkeqësitë kolektive me të cilat do të përballet gjatë tërë jetës poeti i shquar shqiptar. Që herët do të mbetet jetim, pa nënën dhe pa babanë. Por jetim do të mbetet edhe karshi Kosovës së vet të lindjes, e cila ashtu siç e pa dhe e gjeti si fëmijë dhe të atillë e përcolli deri në fund të shekullit, do të jetë nën terror të pandërprerë, nën masakrat e pushtuesit të huaj. Dhe në këtë kontekst të fatit të vet dhe atij kosovar, poetin do ta godasë edhe fatkeqësia e quajtur Lumi-biri, të cilin ia rrëmbeu vdekja në moshën e re. Përballë këtij mozaiku të fatit kosovar dhe podrimjan, poeti Ali Podrimja do të zhvillojë një luftë stoike, me vullnet të ndezur, duke i përballuar të gjitha goditjet e fatit individual dhe kolektiv. E tërë poezia e tij, në fakt, bart në vete shqetësimin, dramën, tragjizmin e këtij fati, duke u artikuluar si art majash në letërsinë bashkëkohore shqiptare, si art poetik që çan rrugë dhe pranohet si vlerë universale.

Marrëdhënia simbiotike mes gjuhës dhe letërsisë ka bërë që letërsia të jetë objekt studimi për gjuhëtarët dhe gjuha për studiuesit e letërsisë. Shfaqja unike e gjuhës në komunikimin letrar, si një lloj i veçantë, është burim i zhvillimit të gjuhës në periudha të ndryshme. Në sistemet letrare zënë fill njësitë e reja leksiko – semantike të një gjuhe, ku në fillim shfaqen si përdorime të figurshme dhe më pas bëhen pjesë e natyrshme të vetëdijes gjuhësore të folësve të asaj gjuhe. Në historinë e zhvillimit të letërsisë së një kombi periudhat më të ndritura të saj, janë njëkohësisht edhe momente më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës.

Larmia e madhe e stileve në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX, sidomos pas viteve '60, të mundëson përthyerjen në dritën e shumë aspekteve teorish e metodash të ndryshme, për shkak të larushisë që mbart kjo poezi në sferën strukturore, por edhe ideore.

Larmia e formave shkrimore, kryesisht llojshmëria e formave poetike në ditët e sotme lind domosdoshmërinë e analizave si formale dhe konceptuale mbi gjuhën e llojeve të ndryshme të poezisë. Letërsia si arti i fjalës gdhend formën e vargëzuar ose jo, me fjalën e lëvizjet kuptimore të saj. Të punosh eksperimentalisht mbi gjuhën dhe mbi kulturën që ajo vë në qarkullim, do të thotë pra të punosh në dy fronte: në frontin e shënjesit me fjalët (dhe kur shkatërron dhe riorganizon fjalët riorganizon mendimet) dhe duke luajtur mendimet, duke e çuar kështu fjalën të prekë horizonte të reja e të pamenduara.

Lëvizja kuptimore me metaforë do të behët objekt i punimit tonë duke u ndalur në gjuhën e poezisë, kryesisht poezisë moderne. Ka pak studime mbi gjuhën e poezisë dhe ky punim shërben për të pasuruar sfondin e trajtesave mbi gjuhën e larmishme të poezisë. Poezia moderne zhvilloi dy nga konvencionet e saj kryesore: përdorimin e saktë, ndonjëherë dhe të tejmbushur me metafora, si dhe

përdorimin e programuar të prozodive jo metrike. Metafora nuk është fakt gjuhësor formal, as “zbukurim i jashtëm, as lojë fjalësh”.

Motivet tematike, idetë krijuese, kredoja unikale poetike, risitë strukturore stilistike, bota e pasur e poezisë me funksione të shumta, jo vetëm në artikulimin në trajtat më të plota dhe të mirëformuara të kredos poetike, por edhe për shfaqjen e mundësive dhe potencialeve semantike, leksikore, sintaksore dhe forcës shprehëse të të folmes nga ai vinte, e bëjnë Podrimjen një zë të veçantë në botën e letrave shqipe, madje e radhitin atë krah kolosëve të kësaj bote.

Kjo e bëri Podrimjen, ashtu si shumë autorë të tjerë, të arrijë kulmet e përsosjes gjuhësore e të figuracionit të thellë poetik.

Poetika e Podrimjes është në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja dhe origjinale të shprehjes së emocionit, të imagjinatës dhe të filozofisë së jetës që vijnë dhe shfaqen përmes një simbolike të dendur në një cikël poezish: *Guri, Kulla, Cungu, Poema e heshtjes, Kali i Trojës, Dëftore dhe Pylli*.

Titujt e cikleve poetike të mësipërme janë kryekëput simbolikë. Simbolika e tyre na orienton drejt kulturës dhe historisë shqiptare. Simbolika e tyre është domethënie e pasurimit strukturor të këtyre leksemave, e një aktualizimi semantik të mbishtresëzimeve të tyre që nga kohët antike deri në kohët moderne.

- Guri është shprehje e qëndresës që në kohët e lashta, është shprehje e autoktonisë në vendin e tij.
- Kulla është simboli i qëndresës përballë invazionit të vazhdueshëm, është simbolika e shpirtit të shqiptarit në viset e Kosovës, është djepi i lirisë dhe intimiteti të tij personal.
- Cungu, simbol i cungimit të individit në një regjim diktatorial, shovinist, por edhe i mostjetërsimit edhe pse i cunguar.
- Heshtja, simboli i censurimit dhe të një mënyre të mbijetesës. Marrëdhënia përcaktuese mes fjalës heshtje dhe fjalës poemë, bën që leksema “heshtje” të ketë një mbishtresëzim kuptimor tjetër antonimik, ku heshtja është një poemë, një rebelim i poetit. Heshtja është syri i fjetur me fyell në gojë, të cilit i cicërojnë zogjtë, ndaj ajo është më e vjetër se guri dhe më e fortë se vdekja.

Poetika e Podrimjes është strukturuar duke u mbështetur mbi metaforën, simbolin, por në fazën e tretë të krijimtarisë së tij kemi poetikë më të prerë, më të drejtpërdrejtë me një shkallëzim të ironisë deri në sarkazëm. Tradita kulturore, format e letërsisë gojore, konteksti social dhe historik të njëjtë për Podrimjen kanë bërë të mundur të kemi shumë pikëtakime në formë, temë

dhe motive tematike mes këtij poeti të hapësirës gjeografike të njëjtë, të qytetit të Gjakovës. Pa frikë mund të pohojmë se ligjërimi poetik në gjuhën shqipe vazhdon në përsosjen formale të saj edhe më tej, në letërsinë shqipe në Kosovë, përmes poezisë së Ali Podrimjes.

Është e natyrshme, që ligjërimi poetik i gjithsecilit prej poetëve shfaq unikalitetin e tij në formën e ligjëritimit në orientimet e drejtimeve dhe rrymave, ndaj secili prej tyre qëndron si një zë i veçantë në botën e letrave shqipe.

Një nga tiparet më të rëndësishme që e identifikon stilin e autorit është koncepti i dominantës, apo i shpeshhtësisë së përdorimit. Këtë koncept e ka sqaruar në mënyrë të detajuar një prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të formalizmit rus, studiuesi Roman Jakobson, i cili dominanten e konsideron si elementin qendror të veprës artistike: ajo i orienton, i përcakton dhe i shndërron të gjithë përbërësit e tjerë të strukturës poetike. Është dominantja ajo që i jep veprës veçanësinë dhe njëherësh, garanton tërësinë e strukturës, duke lidhur formën me përmbajtjen në një unitet të pandashëm.

Në lartësinë e vet artistike poezia e Ali Podrimjes shkëlqen misionare: poeti që nga fillimet ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, vizion që mund të konsiderohet edhe si një ndërmarrje donkishoteske e llojit të vet, e zëri i tij poetik do të jetë thellësisht tronditës, i mprehtë, i qëndrueshëm, bartës i dhembjeve së të gjithëve. Prandaj poezia e tij, e përcaktuar, e lindur në valët e këtij shqetësimi dhe misioni nuk do të jetë në asnjë rrethanë një latent dëshpërues, i pashpresë i vuajtjes dhe dhimbjes, por përkundrazi, vargu i tij do të jetë mobilizues në drejtim të mbrojtjes së frymës, do të jetë një mburojë e shpirtit kolektiv gjatë vuajtjeve epokale të popullit të vet dhe poezi pa të cilën vuajtja dhe dhembja do të ishin tragjike, të pashpresa dhe absurde.

Letërsia shqiptare, në shekullin XX, shënon arritje të mëdha si në aspektin tematik ashtu edhe në atë formal. Në gjysmën e parë të shek. XX mbizotëronte poezia si formë më e lëvruar në të gjitha trojet shqiptare dhe tema më dominante nuk ishte uniforme në të gjitha trojet. Në trungun mëmë shihen përpjekjet e para të një letërsie me temë sociale (Migjeni, Kuteli), nga ana tjetër vihet re përpjekja e afrimit tematik me letërsinë botërore (Poradeci, Koliqi, Konica). Në trojet jashtë trungut mëmë mbizotëronte tema atdhetare dhe forma poetike më e lëvruar ishte poezia. Ekzistenca e këtyre tipare ishte e kushtëzuar nga faktorë historiko-social, formimi letrar e gjuhësor i shkrimtarëve. Në gjysmën e parë të shek. XX, krahas poezisë fillon e lëvrohet edhe proza, sidomos ajo e shkurtër. Gjysma e dytë e shek. XX botën e letrave e ndan për një kohë të gjatë në dy pjesë. Në këtë periudhë letërsia shqipe, brenda trungut mëmë, censurohet tematikisht dhe formalisht nga parimet e të ashtuquajturës letërsi e sociorealizmit.

Në shkrimet për poezinë e Podrimjes është prekur tipologjia e poezisë së tij; forma e saj, stili, figuracioni dhe sintaksa, mesazhi i poezisë, fazat nëpër të cilat ka kaluar ajo, si dhe rëndësia dhe vendi i këtij poeti në letërsinë mbarëshqiptare. Përmes kritikës recensioniste është përcjellë poezia e Ali Podrimjes nga vëllimi i parë e deri tek ai i fundit. Në të, kritikët nga më të ndryshmit, disa me mundësi më të mëdha e disa më të vogla, i kanë shprehur gjykimet e tyre për këtë poezi. Në këto shkrime kritikët rrokin anë të ndryshme të poezisë së Podrimjes, shtresa të ndryshme semantike dhe poetike të saj. Është përcjellë procesi i evoluimit krijues, i cili nuk është i thjeshtë, po i ndërlikuar dhe vështirësitë me të cilat mund të ndiqet ai, sepse ai, nga libri në libër, të shumtën e herës, shënohet një kërcim kualitativ, që e bën të diskutueshëm punën e kontinuitetit dhe diskontinuitetit të poezisë së tij. Që në krye të herës kritikët kanë vërejtur se Podrimja i është shmangur deskripcionit dhe narracionit, që ishin prirje zotëruese në poezinë e etapës së parë të letërsisë së sotme shqipe. Ai është quajtur poet bashkëkohës dhe modern, poet që ka përvetësuar mundësinë e shprehjes moderne poetike pa e keqpërdorur atë. Është trajtuar stili i tij, stilin ekspresionist, trajtat e perceptimit të realitetit, bota që depërton në poezinë e tij, realiteti i brendshëm i krijuar në bazë të intuitës së poetit etj. Janë veçuar vëllime të veçanta të tij, nga ai —Sampo, pastaj —Torzo, ku mbi të gjitha veçohet —Lum Lumi, të cilit kritikët i kushtojnë një rëndësi të veçantë. Poezia e Podrimjes është emërtuar si poezi e sintaksës së lashtë, ndërsa ai është quajtur poet vizionar. Poezia më e re e Ali Podrimjes, sipas kritikës, është përsëri poezi e revoltës dhe e protestës së artikuluar fuqishëm kundër padrejtësisë jo vetëm sociale, por edhe njerëzore, ndërsa lajtmotiv i poezisë së tij është dhe mbetet fati, ekzistenca kombëtare, madje edhe kur ligjëron për tema e motive, në të parë, të largëta. Gjerësisht me poezinë e Podrimjes është marrë edhe kritika që është zhvilluar dhe zhvillohet në Shqipëri, sidomos pas viteve '90 e këtej. Por, një e metë e kritikës për poezinë e Podrimjes, të shkruar në Shqipëri, është interpretimi patriotik që i bëhet asaj; ku në çdo varg të tij kërkohet angazhimi atdhetar i poetit. Këta kritikë, si Bashkim Kuçuku, Roland Zisi, Jolanda Lila etj., nxjerrin kuptimësi patriotike edhe aty ku nuk ka. Angazhimi i Podrimjes me vargje për çështjen kombëtare, kundër padrejtësive që i bëhen pjesëtarit të këtij populli, në faza të ndryshme, është mjaft i pranishëm, por ky angazhim nuk duhet kërkuar në çdo varg të tij, prapa çdo figure të poezisë së tij, sepse kështu do të ngushtohet semantika e kësaj poezie. Në poezinë e Podrimjes, universalja dhe kombëtarja janë të pranishme, këtë kritikë duhet ta bëjë të qartë dhe jo që ta reduktojë të gjithë poezinë e Podrimjes në angazhimin kombëtar. Këtë ngushtim të kuptimit të poezisë së Podrimjes unë e shoh si pamundësi e kësaj kritike për të depërtuar në kuptimet e saj, por edhe si mungesë vullneti për të depërtuar në këto kuptime që i ndërthrin kjo poezi. Në radhë të parë, për të interpretuar një poezi të Podrimjes, apo edhe sistemin e figuracionit të poezisë së tij, duhet të kihet parasysh koha e krijimit të poezisë, sepse jo rrallë kjo poezi ndërlidhet me kontekstin kohor, por

edhe me atmosferën krijuese në Kosovë. Pastaj do të duhej që poezia e tij të krahasohej me poezinë e krijuesve të tjerë, e cila është krijuar në këtë kohë. Si përfundim, megjithëse për poezinë e këtij poeti të madh është shkruar shumë, të rralla janë shkrimet që kanë depërtuar në thellësi të saj. Kritikët dhe studiuesit e ndryshëm kanë prekur pjesë të poezisë së tij, por jo tërësinë e saj. Tani, pasi më krijuesi i madh fizikisht nuk ndodhet në mesin tonë dhe kur janë shkruar qindra shkrime për këtë poezi, studiuesve u bie për detyrë ta studiojnë poezinë e tij në tërësinë e saj, si një të tërë, ta studiojnë sistemin e tij poetik dhe ta bëjnë kështu sintezën e këtij sistemi. Pra, mund të themi se studimi i vërtetë i poezisë së tij fillon tani.

## BIBLIOGRAFIA:

- Arapi, Fatos, *Në kërkim të lirisë, atdheut, njeriut*, parathënie e vëllimit poetik *Libri mbi të qenit* të Ali Podrimjes, Kosova Pen Center, Prishtinë, 2009.
- Arapi, Fatos, *Podrimja, shprehës i shpirtit dhe mendimit shqiptar*, Albania, Tiranë, 29 gusht 2002
- ASHAK, *STUDIME-Revistë për studime filologjike* Prishtinë, 2014.
- Bejko, Sadik, *Ali Podrimja, poeti i estetikës*, Albania, Tiranë, 30 nëntor 2004.
- Bogiqi, Halit, *Semantika dhe struktura e fuqishme e një poezie*, Fjala, Prishtinë, 1 prill 1979.
- Çiraku, Ymer, *Poezia e gjysmës së dytë të shek. XX si hierarki vlerash*, në: *"Fenomeni i Avanguardës në letërsinë shqiptare (Aktet e seminarit shkencor)"*, Arbëria, Tiranë, 2004.
- Eko, Umberto, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2008.
- Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.
- Hamzai, Dhurata, *Poezia e Podrimjes, shqisa dëshmitare*, Tema, Tiranë, 31 korrik, 2008.
- Horodyska, Dorota, *E bukura fisnikëron të vërtetën*, Rilindja, Prishtinë, E mërkurë, 21 prill 1993.
- Kuçuku, Bashkim, *Antologji e poezisë shqipe bashkëkohore*, (parathënie: "Larmia e madhe e stileve"), Onufri, Tiranë, 2008.
- Kuçuku, Bashkim, *Parathënia e librit, Litari i ankthit*, Botimet Toena, Tiranë 2002.
- Kundera, Milan, *Testamentet e tradhëtuarat*, Tiranë, 2011.
- Lila, Jolanda, *Torzioni i qenies*, Saga, Prishtinë, 2011.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999.
- Maloku, Flamur, *Shtresëzimi i tekstit*, Tema, Tiranë, E diel, 9 nëntor 2008.
- Miftari, Vehbi, *Dëshmia poetike, ekzistenciale*, Tema, "7 mars", 2009.
- Musliu, Ramadan, *"Poezi e ndjenjës së rëndë"*, *Ali Podrimja: "Lum Lumi"*, Rilindja, Prishtinë, 1986,
- Thjerrëza, Nr.11, Prishtinë, 1 qershor 1986.
- Myrtaj, Faruk, *Kur atdheu mungon, prej Arbërisë në Çamëri*, Albania, 14 shtator, 2003.
- Myrtaj, Faruk, *Shndërrimi i Lumit në Perendi dhe Muzë, Një lexim tjetër i poezisë së Ali Podrimjes*, Albania, Tiranë, 18 qershor 2002.
- Podrimja, Ali, *Litari i ankthit, poezi te zgjedhura*, Toena, Tiranë, 2002.
- Podrimja, Ali, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012.
- Podrimja, Ali, *Pikë e zezë në blu*, Onufri, Tiranë, 2005.
- Podrimja, Ali, *Vepra 3, Credo*, ASHAK, Alfa Print, Prishtinë, 2013
- Podrimja, Ali, *Verpa letrare 6, Rekuim për pyllin e prerë*, ASHAK, Alfa Print, Prishtinë, 2013.
- Prendi, Arben, *Ferri poetik i Podrimjes*, Rilindja, Prishtinë, 6 janar 1994.

Rizai, Shefqet, *Podrimja ironik, racional, i papërsëritshëm, Libri me poezi "Pikë e zezë në blu" na shëtit në fatin tragjik të kombit*, Tema, Tiranë, 23 dhjetor 2006.

Roman, Jakobson, *Language in Literature, "The dominant"*, Harvard University Press, Unitet States of America, 1987.

Saporta, Sol, *The Application of Linguistics to the Study of Poetic Language*, in *Style in Language*, Indiana University, 1958.

Shatro, Baviola, *Poezi që sfidon*, Tema, Tiranë, 31 korrik, 2009.

Shita, Vehap, *Gjurmave të letërsisë*, Prishtinë, 1999.

Tafa, Bujar, *Biografemat dhe ideografemat (Lum Lumi i Ali Podrimjes)*. Universiteti AAB Riinvest, Prishtinë, 2010.

Thomai, Jani, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (semantikë leksikore)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, EDFA, Tiranë, 2009.

Vinca, Agim, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945 – 1980)*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997.

Wellek & Woren, *Theory of literature*, Harcourt Brace & World, New York, 1956.

Zisi, Roland, *Letërsi bashkëkohore shqiptare (poezia)*, Tiranë, 2008.